



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna Rahovec / Opštine Orahovac /Municipal Rahovec

RAPORT VJETOR PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS SË RAHOVECIT PËR VITIN 2016

Janar- Dhjetor 2016

1.Grupi punues që hartoi raportin vjetor për vitin 2016.....	2
2.Hyrja.....	3
3.Kryetari i Komunës së Rahovecit, z. Idriz Vehapi.....	4-5
4.Zyra për Informim, z.Haziz Krasniqi, Njomëza Fazliu, shefe e kabinetit në zyrën e kryetarit	5
5.Zyra e Personelit, z. Ymret Reshiti	6-8
6. Zyra ligjore, z. Isak Hoti.....	8
7.Zyra për përfaqësim ligjorë.....	9-10
9.Zyra për Komunitete dhe Kthim, z.Jovan Bojiq	10-12
10.Drejtori i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, z. Avdullah Kryeziu	12-16
11.Drejtoria për Punë Inspektuese, z. Admir Oruqi	16-17
12.Drejtori i Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme, z. Sali Sallteku	17-20
13.Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, z. Munib Durguti.....	20-24
14.Drejtori i Drejtorisë për Arsim, znj. Vjollca Vuçiterna.....	24-28
15.Drejtoria për Buxhet dhe Financa, z. Lulzim Sylejmani.....	28-31
16.Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, z. Feim Fetoshi.....	31-32
17.Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, z. Fehmi Hoxha.....	32-38
18.Drejtoria e Drejtorisë për Shërbime Publike, z. Muhamet Behra.....	38-41
19.Drejtoria e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, z. Gardalin Shtavica	41-44
20.Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, z. Bislim Morina.....	45-48
21.Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë z. Kujtim Popaj.....	48-50

HYRJE

Komuna e Rahovecit për çdo ditë e më shumë po numëron të arriturat dhe po përmbushë obligimet ndaj qytetarëve. Mund të themi se kemi ndërtuar një administratë të qëndrueshme, efikase dhe të përgjegjshme, e cila në vazhdimësi po i përgjigjet kërkesave të qytetarëve dhe është duke ofruar shërbime me standarde të larta profesionale, të gjitha kërkesat procedohen me shpejtësi dhe kujdes të veçantë.

Është bërë progres i mirë në shumë fusha si në infrastrukturën rrugore, ndriçim, përmirësimin e kushteve në arsim, në shëndetësi, shërbime publike, zhvillimin e bujqësisë dhe kjo punë do të vazhdojë edhe më tutje deri në përmbushjen e qëllimeve dhe objektivave të parashtruara. Jemi duke fuqizuar edhe më tej partneritetin në nivel qeveritar e lokal, me institucione e organizata qeveritare e joqeveritare, shoqërinë civile, me të rinjtë, me bizneset e Komunës së Rahovecit ashtu që të rinjtë të mund të fitojnë përvojë. Në vazhdimësi jemi të përkushtuar në përmirësimin e mëtejshëm të ofrimit të shërbimeve në të gjitha fushat e jetës. Arritjet tona janë arritje të përbashkëta me qytetarët tanë dhe institucionet tona.

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË ZYRËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS SË RAHOVECIT JANAR-DHJETOR 2016 z. IDRIZ VEHAPI

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2016, janë realizuar objektivat programore të planifikuara përmes projeksioneve buxhetore për realizimin e projekteve nga sektorë të ndryshëm me interes për qytetarët e komunës sonë.

Prioriteti i politikave publike në vazhdimësi kanë qenë ngritja e cilësisë së shërbimeve komunale administrative dhe realizimi i kërkesave të qytetarëve për projekte në infrastrukturë të përgjithshme si në fshatra, po ashtu edhe në qytetin e Rahovecit, e në veçanti në vendet ku është punuar pak, për të mos thënë nuk është punuar fare në të kaluarën.

Jemi angazhuar fuqishëm që të arrijmë nivelin më të lartë të transparencës komunale dhe në vazhdimësi jemi kujdesur që praktikat më të avancuara demokratike të aplikohen gjatë vendimmarrjes në Qeverinë Komunale.

Në vijim po i prezantojmë disa nga aktivitetet të kryera për periudhën Janar – Dhjetor 2016:

- Realizimi i projekteve prioritare të përcaktuara për vitin 2016.
- Takime të rregullta çdo të hënë me drejtorët e drejtorive, ku janë diskutuar tema të ndryshme, të cilat kanë të bëjnë me interesin e qytetarëve të Komunës së Rahovecit, ndërsa mbledhjet konsultative kanë qenë ditore.
- Janë mbajtur 6 takime të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Rahovecit.
- Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme të qytetarëve, të cilat kryesisht kishin të bënin me ndihma për shërim, ku në vazhdimësi iu është dalë në ndihmë dhe janë përkrahur me mjete financiare.
- Vazhdimi i mbajtjes së takimeve periodike me nëpunësit civil të Administratës Komunale (nëpunësit e secilës drejtori veç e veç).
- Mbajtja e shumë takimeve zyrtare të realizuara me institucione vendore dhe ndërkombëtare, siç janë: ambasadorë të vendeve të ndryshme, si dhe donatorë të ndryshëm. Në këto takime, kryesisht është biseduar për tërheqjen e investimeve për Komunën e Rahovecit.
- Nxjerrja e shumë vendimeve, ku përfshihen vendimet për subvencione dhe për formimin e komisioneve për pranime teknike, vlerësime të ofertave, vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vlerësimet të cilët kanë ndodhur si pasojë e reshjeve atmosferike-shiut, mbështetje të OJQ-ve dhe për fusha të caktuara, si dhe nënshkrimi i shumë urdhërësive që kanë të bëjnë me fillimin e procedurave tenderuese.
- Janë mbajtur dy takime publik me qytetarë dhe disa takime publike të tjera, ku është diskutuar për rregullore dhe plane të ndryshme të cilat kanë pasur të bënin direkt me qytetarët.
- Vizita të kohëpaskohshme nëpër lokalitetet e Komunës së Rahovecit dhe takime me banorët e fshatrave.
- Takime me qytetarë janë mbajtur çdo të hënë nga ora 13-15, në këto takime është diskutuar për çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me jetën e përditshme të banorëve të Komunës së Rahovecit.
- Propozimi i Rregulloreve dhe Vendimeve të ndryshme nga fushëveprimi dhe kompetencat komunale, të cilat i janë kaluar Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës për miratim.
- Gjatë periudhës Janar-Dhjetor, kemi vazhduar me bashkëpunimin e mirë me mediat lokale e nacionale dhe kohë pas kohe i jemi përgjigjur intervistave në TV-të qendrore, mediave të shkruara, e po ashtu edhe atyre elektronike.
- Kemi zhvilluar takime bashkëpunimi me OJQ-të komunale siç janë: OJQ OPFAKOS , Këshilli Rinor i Rahovecit, OJQ “Hareja” dhe organizata tjera që veprojnë në komunën tonë dhe më gjerë, si dhe punët dhe detyrat tjera të rregullta nga fushëveprimi dhe kompetencat e Kryetarit të Komunës të përcaktuara me ligjet në fuqi.

Marrëveshjet e bashkëpunimit-bashkëfinancimit dhe kontrata të nënshkruara me donator të ndryshëm Janar- Dhjetor 2016

Për periudhën Janar-Dhjetor, Kryetari i Komunës së Rahovecit, ka nënshkruar 20 marrëveshje bashkëpunimi-bashkëfinancimi dhe kontrata të ndryshme me organizata të huaja që veprojnë në Republikën e Kosovës, si dhe me organizata vendore. Po ashtu, janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi-bashkëfinancimi edhe me ministrinë siç janë marrëveshjet: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunës së Rahovecit për “Rregullimin e shtratit të Lumit Rimmik”, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunës së Rahovecit për “Rregullimin e shtratit të lumit Duhlo”. Marrëveshje Mirëkuptimi në mes të Komunës së Rahovecit dhe Zyrës së Kryeministrit-Zyrës për Çështje të Komuniteteve për projektin “Rregullimi i shtratit të lumit në fshatin Hoçë e Madhe”. Marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi në mes të Komunës së Rahovecit dhe kompanisë “Meditech”, për “Trajnimin e personelin shëndetësor të QKMF-së, në Qendrën Spitalore të Dializës në Prizren si dhe në Repartin Nefrologjik pranë QKUK-së për aftësim profesional”. Marrëveshje bashkëfinancimi në mes të Komunës

së Rahovecit dhe IOM-it për “Rregullimin e fushës së basketbollit në fshatin Hoçë e Madhe”. Marrëveshje bashkëpunimi në mes të Komunës së Rahovecit dhe Postës së Kosovës për “ Bashkëpunim dhe asistencë të ndërsjellët për çështjet me interes të përbashkët, lidhur me lehtësimin e qasjes në shërbime postare dhe shërbimet e pagesave të qytetarëve të cilët kryejnë në hapësirat e Komunës”. Marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi në mes të Komunës së Rahovecit, Ministrisë së Shëndetësisë dhe “Caritas Kosova”, në kuadër të kësaj marrëveshje janë punësuar 31 punëtorë shëndetësor. Marrëveshje Komuna e Rahovecit me “Caritas Kosova”, për projektin “Edukimi Parashkollor në Komunën e Rahovecit”. Marrëveshje mirëkuptimi Komuna e Rahovecit, Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe OJQ “Këshilli Rinor i Rahovecit”. Marrëveshje në mes të Komunës së Rahovecit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame në Rahovec për “Mbulimin e Shpenzimeve për shërbimet e varrimit”. Marrëveshje bashkëfinancimi në mes të Komunës së Rahovecit dhe IOM-it për “Rregullimin e oborrit të Sh.f.m.u “Bekim Sylka”, në qytetin e Rahovecit”, në kuadër të kësaj marrëveshje janë punësuar 65 punëtorë për kohë të caktuar. Kryetari i Komunës së Rahovecit ka lidhur edhe kontrata me Organizata të ndryshme siç janë ajo me Projektin Zviceran DEMOS-Komuna e Rahovecit për “Verifikimin e Pronave Komunale”, në kuadër të kësaj kontrate janë punësuar 6 punëtor me kohë të caktuar. Kontratë e lidhur në mes të Komunës së Rahovecit dhe DEMOS-it për “Rregullimin e trotuarit në rrugën e UÇK-së në qytetin e Rahovecit”. Kontratë e lidhur nga Komuna e Rahovecit dhe Posta e Kosovës “Për Shpërndarjen e Faturave të Tatimit në Pronë”, Memorandum Mirëkuptimit mes të Komunës së Rahovecit dhe Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) , Memorandum Bashkëpunimi në mes të OJQ Zëri i Romëve , Ashkalinjëve dhe Egjiptasve “ Përfshirja Sociale dhe përmirësimi i kushteve të jetesës për komunitetin Romë , Ashkali dhe Egjiptian dhe grupe të tjera të cenuara në Kosovë “, Marrëveshje ndërmjet Komunës së Rahovecit dhe KRU “Radoniqi” Sh. A-Gjakovë “Bashkë investimi në realizimin e projektit Ekzekutimi i fazës së dytë të Përpunimit të Ujit të Pijes , Kontratë në mes Komunës së Rahovecit dhe Demos “ Rregullimi i trotuareve në rrugën e UÇK-së (krahu i majtë)-qyteti i Rahovecit – faza III .

Vizitat jashtë shtetit

Vizitën e parë jashtë shtetit e kam realizuar me datat 06-07 qershor 2016, kjo vizitë është realizuar me ftesë nga Klubi Slloven i Biznesit, së bashku me Oden Ekonomike Sllovene dhe Spirit Slloveni. Gjatë kësaj vizite në Slloveni është mbajtur edhe një konferencë me temën: “Zhvillimi i investimeve në Kosovë”.

Me ftesë të kryetarit të Bashkisë së Përmet në Shqipërisë, kam qëndruar për vizitë për vizitë dy ditore nga data 14 deri 15. Tetor .2016.

Me ftesë të projektit Zviceran DEMOS, me datat 29 dhe 30 nëntor 2016, kam marrë pjesë në një punëtori në Maqedoni-Shkup me temë: “Planifikimi vjetor të punës për vitin 2017”.

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË ZYRËS PËR INFORMIM DHE KABINETIT TË KRYETARIT JANAR-DHJETOR 2016 HAZIZ KRASNIQI- NJOMEZA FAZLIU

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor, ka pasur në vazhdimësi zhvillime të cilat me pasur edhe janë pasqyruar në faqen zyrtare të Komunës, si dhe në mediat e shkruara dhe ato elektronike. Takimet e kryetarit me përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues ndërkombëtar dhe delegacione qeveritare, janë pasqyruar realisht, ndërsa angazhimet e sektorëve të cilat janë nëpër drejtori të ekzekutivit të komunës kanë gjetur hapësirë të mjaftueshme në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe janë përgatitur edhe dokumente të cilat kanë të bëjnë me transparencë siç është Strategjia për Komunikim dhe Informim 2017-2022, Plani për Transparencë dhe i aktiviteteve të Komunës së Rahovecit për vitin 2016, për përgatitjen e këtyre dokumenteve janë mbajtur edhe debate publike të organizuara nga Zyra për Informim, Kabineti i Kryetarit në bashkëpunim me OSBE-në zyra në Rahovec.

Janë mbajtur kontakte të rregullta me gazetarë të dy portaleve lokale, si dhe me shumë media elektronik kryesisht me Radion dhe Televizionin e Kosovës (RTK), Koha Vizion (KTV), portali Koha .net, Radio Televizioni 21 (RTV 21), Televizionin Klan Kosova, Tv Opinion, TV Prizreni, Radion Kosova e lirë, agjencia e lajmeve Kosovapress, agjencia e lajmeve Ekonomiaonline dhe me mediat të tjera të shkruara.

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË ZYRËS SË PERSONELIT JANAR-DHJETOR 2016 Z.YMRET RESHITI

Gjatë kësaj periudhe kohore, Njësia e personelit ka ndërmarr disa aktivitete:

Organizimi dhe menaxhimi i dosjeve të punëtorëve

-Njësia e Personelit gjatë kësaj periudhe kohore ka bërë përditësimin e të dhënave statistikore të punëtorëve si dhe menaxhimin e dosjeve të personelit.

Janë përgatitur 4 dosje të punëtorëve të rinjë të administratës komunale. Gjithashtu tre (3) dosje tjera të punëtorëve kanë kaluar në dosje pasive, pasi që tre punëtorëve iu është ndërprerë marrëdhënia e punës .

Nga (shkurti i vitit 2015) ka hyrë në fuqi programi elektronik „ Sistemi informativ i menaxhimit të burimeve njerëzore” i cili bazohet në Katalogun e vendeve të punës që është hartuar nga MAP, dhe është miratuar nga Qeveria e Kosovës.

Tani të gjitha procedurat e rekrutimit dhe marrja e autorizimit nga MAP-ja për shpallje të konkurseve për shërbyesit civil duhet të procedohen sipas programit „SIMBNJ”. Komuna e Rahovecit është në zbatim të këtij programi .

Është bërë futja e të dhënave të nëpunësve civil të komunës në programin elektronik „SIMBNJ” sipas klasifikimit të vendeve të punës se miratuar nga Qeveria .

Vlerësimi punës provuese

Gjatë kësaj periudhë kohore katër (4) punëtorëve iu është konfirmuar kryerja me sukses e punës provuese dhe janë njoftuar me kohë për vazhdimin e marrëdhënies së tyre të punës.

Pushimet e punëtorëve

-Gjatë kësaj periudhe kohore kanë përfunduar shfrytëzimi i pjesës së mbetur të pushimit vjetor 2015, dhe 111 raste kemi që është hapur shfrytëzimi i pushimit vjetor të vitit 2016.

-Transferimeve të punëtorëve -ndryshimet në pozitë

Gjatë kësaj periudhe kohore ka pasur një (1) transferim të përhershëm të punëtorëve:

-Nga Zyra e Kryetarit të komunës është transferuar një (1) punëtor, në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

Me rastin e transferimit nuk ka pasur ndryshim të koeficientit të pagës mujore të punëtorit.

Procedura e rekrutimit

-Gjatë kësaj periudhe kohore ka pasur tre (6) konkurse publike, dhe janë pranuar katër (5) punëtor:

- një Zyrtar për vlerësimin e pronës pranë Drejtorisë për Buxhet dhe Financa .

- një Zyrtar për informim pranë Zyrës së Kryetarit të Komunës.

- një Asistent administrativ pranë QPS-së në DSHMS-së.

- një Zyrtare e gjendjes civile 4 në zyrën e vendit në Xërxe pranë Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme.

- një Zyrtare e gjendjes civile 4 në zyrën e vendit në Hoqë të Vogël pranë Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme por kandidatja fituese nuk ka dashur që të nënshkruaj Aktin e emërimit ngase nuk ka qenë e interesuar që të themeloj marrëdhënie pune me komunën e Rahovecit.

Ky konkurs është rishpallur në muajin nëntor por është anuluar ngase kanë qenë vetëm dy aplikacione të cilat i kanë plotësuar kushtet e konkursit ndërsa sipas dispozitave juridike minimum nevojiten tre aplikacione të përgjegjshme, për të vazhduar me fazat tjera të rekrutimit.

Është shpallur konkursi për rekrutimin e Udhëheqësit të sektorit për kthim dhe komunitete dhe është anuluar ngase ka pasur vetëm tre aplikacione ndërsa sipas dispozitave juridike kërkohet minimumi 5 aplikacione.

Kemi pasur konkurse publike të financuar organizata „HELVETAS Swiss Intercooperacion –fondacioni Zviceran për Zhvillim dhe Bashkëpunim në realizim të projektit „Verifikimi i pronave Komunale ” ku janë pranuar gjashtë (6) punëtor me kontratë për punë dhe detyra specifike në kohëzgjatje për tre (3) muajsh, si :

-tre juristë pranë Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

-tre gjeodet pranë Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë .

Gjithashtu është shpallur një konkurs publik nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit për pranimin:

- e një asistenti/e me kontratë për punë dhe detyra specifike, për kohëzgjatje për tre(3) muaj.

Ndërprerja e marrëdhënies së punës

– Gjatë kësaj kohe 3 punëtorëve iu është ndërprerë marrëdhënia e punës . Dy punëtorët me dëshir kanë dhënë dorëheqje nga pozita e punës ndërsa një punëtor sipas vendimit të formës së prerë të gjykatës kompetente i është ndërprerë marrëdhënia e punës.

Gjatë kësaj periudhe kohore 5 punëtorëve iu është dërguar Njoftimi për daljen e tyre në pension në vitin 2017.

-Lëshimi i akteve administrative

-Njësia e Personelit gjatë kësaj periudhe ka hartuar gjithsej 345 shkresa administrative si në vijim: vërtetime, vendime për pushimet vjetore, vendime tjera, draft vendime, propozim vendime, akt emërimi, informata ,rekomandime njoftime, kërkesa, raporte dhe shkresa tjera.

-Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 6 trajnime nga IKAP etj, si dhe janë trajnuar 10 nëpunës civil.

-Mbështetja administrative për Komisioni Disiplinor dhe KZKA-së e komunës

- Njësia e Personelit rregullisht i ofrojnë mbështetje administrative –sekretarisë, për komisionet e lartë përmendura, me profesionalizëm dhe me efikasitet.

Gjatë kësaj periudhe kohore Komisioni Disiplinor kemi pasur dy raste - kërkesë për ndjekje disiplinore.

- Një rast me vendim të KD-së punëtorja është shpallur e pa fajshme
- Një rast me vendim të KD-së është pezulluar përkohësisht procedura disiplinore sipas kushteve të parapara me LSHCK-së Nr.149.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur për shqyrtim asnjë kërkesë-ankesë .

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës – gjatë kësaj periudhe nuk kemi pranuar asnjë Vendim të KPMSHCK-së .

-Vijueshmëria e punëtorëve në punë

-Nga 1 prilli i vitit 2015 komuna ka instaluar programin elektronik, të përcjelljes së vijueshmërisë-prezencës së punëtorëve në punë, e që është pjesë integrale e programit të prezencës së punëtorëve në punë të programuar nga Qeveria.

Me vendimin e Kryetarit të komunës 01Nr.776/2015 Udhëheqësi i personelit është caktuar monitorues i këtij programi.

Njësia e personeli të gjitha sqarimet dhe udhëzimet e duhura me kohë i ka dhënë për punëtorët dhe drejtorët e drejtorive si dhe i ka vendosur në formë të shkruar te aparatet e sistemit të përcjellëse prezencës së punëtorëve në punë.

-Të dhënat e nëpunësve civil

-Ka dërguar në MAP-në formularët me të dhëna statistikore për punëtorët e administratës komunale, për vitin 2016. Administrata komunale ka aktualisht 157 punëtor, pa stafin mbështetës politik, sektorin e arsimit dhe shëndetësisë.

Totali	Struktura kualifikuese				Struktura etnike									Struktura gjinore	
	Fakulteti	shk. e lartë	shk. e mesme	shk. fillore	sh.	s.	m.	t.	g	a	e	r	të tjerë	m	f
157	62	10	70	15	147	9	1	0	0	0	0	0	0	135	22

* Të dhënat statistikore të personelit rregullisht i dorëzohen Ministrisë së Administratës Publike, ashtu siç kërkohen përmes formularëve standard të shërbimit civil.

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË ZYRËS LIGJORE JANAR-DHJETOR 2016 Z. ISAK HOTI

Zyra ligjore, në kuadër të ushtrimit, përgjegjësisë, autorizimeve si dhe në funksion të zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore, për periudhën një vjeçare nga data 05.01.2016 deri më 31.12.2016, është përpjekur të bëjë një punë cilësore, duke kryer harmonizimin, plotësim ndryshimin dhe hartimin e akteve nënligjore, që janë propozuar nga Kryetari i Komunës, Drejtorët e Drejtorive në Komunën e Rahovecit, Kuvendit Komunal dhe që zyra Ligjore paraqet këtë:

RAPORT TË PUNËS PËR VITIN 2016

- I. Udhëheqja me procedurë administrative sipas lëndëve.
- II. Aktivitetet, ofrimi i këshillave ,opinioneve ligjore për Kryetarin e Komunës, Drejtorive Komunale, sektorëve dhe zyrave në Komunën e Rahovecit.
- III. Hartimi dhe harmonizimi Rregulloreve, hartimi dhe harmonizimi i akteve juridike në përputhje me legjislacionin në fuqi, hartimi, përpilimi i vendimeve, aktvendimeve, urdhëresave, marrëveshjeve, kontratave, kërkesave, autorizimeve, dhe shkresave të ndryshme përcjellëse për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive në Komunën e Rahovecit.
- IV. Veprimet e ndërmarr kanë qenë permanente.
- V. Arkivimi dhe sistemimi i dokumenteve të zyrës ligjore si dhe përcjellja e vazhdueshme e ligjeve, udhëzimeve dhe rregulloreve që dalin nga institucionet qendrore.
- VI. Objektivat e planifikuara për vitin 2016, të realizuara.

Objektivat e arritura

Zyra ligjore për vitin 2016, kontributin e sajë e ka dhënë edhe në fushën e dhënies së opinioneve ligjorë për të gjitha nevojat e administratës në Komunën e Rahovecit përfshirë edhe Kuvendin Komunal gjithashtu konsultat kanë qenë permanente (ditore).

Plotësim ndryshim i Rregullores	3
Draft Statuti i Komunës	1
Vendime	456
Urdhëresa	89
Autorizime	10
Kërkesa	18
Opinione Ligjore	11
Marrëveshje	3
Propozim-vendime	49
Konkluzione	11
Kontrata	23
Punë në komisione	12
Përgjigje në kërkesë	2
Akte përcjellëse	10
Të tjera	5
TOTALI I AKTEVE TË HARTUARA NGA ZYRA LIGJORE	703

**RAPORTI VJETOR I PUNËS SË ZYRËS SË PËRFAQESIMIT LIGJOR JANAR-DHJETOR 2016
Z.BETIM BEHLULI**

Zyra për përfaqësime Ligjore (ZLP) e Komunës së Rahovecit kryen detyrat dhe punët në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës, në bazë të praktikës së Avokaturës Publike Komunale, Ligjeve, Rregulloreve dhe dispozitave të tjera në fuqi nga kompetencat dhe fushëveprimi i kësaj lëmie, Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Statutit të komunës, Planit dhe programit të punës së kësaj zyre.

Detyrat dhe punët më të rëndësishme të Zyrës për Përfaqësime Ligjore janë:

- Përfaqësimi i Komunës në kontestet civile, penale dhe administrative;
- Ushtrimi i padive, përgjigjet në padi, dhe veprimet tjera juridike të nevojshme në të gjitha instancat gjyqësore në Kosovë, në gjykatat e rregullta, ndërmerr veprimet e nevojshme për mbrojtje të interesit të komunës dhe mbrojtje të pronës publike si dhe të mirave të tjera që janë nga interesi i përgjithshëm;
- Jep mendime profesionale juridike, udhëzime dhe rekomandime lidhur me pronën, të mirave materiale e në lidhje me procedurat gjyqësore dhe administrative në mbrojtjen e ligjshmërisë sa i përket punës së organeve komunale;
- Ushtron mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike në emër të komunës

Paditë, përgjigjet në padi, ankesat, përgjigjet në ankesa, prapësimet, mjetet e jashtëzakonshme dhe të gjitha veprimet tjera juridike si dhe parashtrirat tjera janë përpunuar në nivelin e duhur profesional gjatë periudhës raportuese, përgatitjet për seanca janë bërë me kohë , është asistuar në mënyrë aktive në të gjitha seancat procedurale pranë Gjykatave dhe Organeve të tjera kompetente për marrjen e vendimeve.

PASQYRA TABELARE E LËNDËVE SIPAS TË GJITHË REGJISTRAVE PREJ 01.01.-31.12.2016

Regjistri	Lën dë në pun ë	Të pr an në ua ra	Gjith ësejt në punë	Të kry era	Kanë mbet pakr yera	Përgj. në padi, mbr ojtje ndaj padi së dhe prapë sime	Sean cat	Vendi met Shk.I- rë	Ank esat e ZPL	Vendi met Shk.II -të	K M L e ZP L	Rev izi- onet	Ven d. Shk. III- të	Shkr esa të pran uara	Shkr esa të dërg uara
C-Civile	757	26	783	13	770	40	114	25	13	2	1	1	0	200	70
ND-ndryshme	15	5	20	2	18	-	13	2	0	0	-	-	0	19	3
E-Përmba-Rues	40	10	50	6	44	5	3	10	0	0	-	-	-	32	5
Pa.Ka.p roced. Kont.ad minist.	2	3	5	1	4	1	7	2	0	0	-	-	-	12	4
ZPL- Zyra për Përf.Ligj ore	0	10	10	10	0	-	-	-	-	-	-	-	-	0	9
PA- Procedurë	1	6	7	0	7	-	9	3	-	0	0	0	0	12	0

a e At- hezionit															
Gjithëse jt:	815	60	875	32	843	46	146	42	13	2	1	1	0	275	91

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË ZYRËS PËR KOMUNITETE DHE KTHIM JANAR-DHJETOR 2016 Z JOVAN BOJIQ

Brenda këtij viti zyra ka kryer punë të saja të rregullta në saje të kompetencave të cilat i ka:

- Kthimi i personave të zhvendosur.
- Regjistrimi i personave të riatdhesuar.
- Realizimi i projekteve nga fondi i investimeve kapitale.
- Aktivitetet të tjera.

Kthimi:

Në këtë periudhë kemi pasur katër kërkesa për kthim në komunën tonë. ZKKK-ja së bashku me UNHCR-in dhe Ministrin për Kthim (në tekstin e mëtejme MK) i ka kryer vizitat në teren me persona të paraqitur në gjysmën e parë të vitit. Dy kërkesa janë miratuar në mbledhjen qendrore të komisionit në muajin korrik. Dy kërkesa të tjera janë shqyrtuar në mbledhjen e komisionit qendror në muajin dhjetor. Është konstatuar që në ndërkohë duhet të paraqesin dokumentet të tjera të nevojshme, ndërsa vizita dhe intervista në teren do të bëhet në tremujorin e parë të vitit të ardhshëm.

Nga 13 raste të cilat gjenden në listë që nga viti 2011, vetëm njëri i plotëson kushtet për ndërtimin e shtëpisë mirëpo edhe këtë viti sikurse në pesë vitet të kaluara, komuna jonë nuk është marr parasysh ti ndahen fondet nga MK-ja. Të tjerët në listë nuk e plotësojnë kushtin kryesor e që është posedimi i pronës gjegjësisht, parcelës, në mënyrë që ti ndërtohet shtëpia. Problemi më i madhe është ofrimi i strehimit adekuat për personat e zhvendosur pa pronë duke ju ofruar tokë. Dhënia e tokës komunale është parakusht për ndërtimin e shtëpive për persona të zhvendosur të cilët nuk kanë pronë. Problem është gjindja e zgjidhjes adekuate në suaza ligjore të Kosovës. Sfida më e madhe me të cilën po ballafaqohemi më së shumti për zgjidhjen e këtij problemi janë: qasja e alternativës në ndarjen e pronës, alternativa për sigurim në raste kur komunat nuk ka pronë dhe rezistenca e komunitetit.

Kemi pranuar shkresë me të cilën obligohemi që partnerit potencial MK-së, për realizimin e procesit të kthimit, ti mundësojmë furnizim pa pagesë të të gjithë dokumentacionit të nevojshëm nga drejtorit komunale. Kemi parashtruar kërkesë pran MK-së që të ndaj mjete për vitin e ardhshëm, për ndërtimin e shtëpisë personit i cili është kthyer dhe i cili i plotëson kushte.

Regjistrimi i personave të riatdhesuar:

Sa i përket regjistrimit të personave të riatdhesuar nga vendet e BE-së duhet të përmendim që qeveria e Kosovës në muajin prill, ka bërë ndryshimin e pjesës së ligjit për ri-integrimin e personave të riatdhesuar, i cili ka të bëjë me të drejtën e paraqitjes për procesin e ri-integrimit. Deri në muajin prill, të drejtë në programin e ri-integrimit kanë pasur personat të cilët kanë dal nga Kosova deri me 28.07.2010. Nga prilli të gjithë persona të cilët kanë dalë nga Kosova deri në fund të vitit 2015, kanë fituar të drejtë regjistrohen në program me kusht që ti plotësojnë kushtet e caktuara. Marr parasysh mungesën e kapaciteteve dhe kohës që të përgatitemi në afatin e shkurtë kohor, kemi arritur që nëpërmjet njësisë për të drejtat e njeriut dhe personelit të saj, të regjistrojmë të gjithë personat e riatdhesuar të cilët kanë arritur gjatë gjithë muajit. Të gjitha kërkesat janë shqyrtuar dhe dërguar MPB-së për shqyrtim të mëtejme. Të gjitha kërkesat shtesë të personave të riatdhesuar janë shqyrtuar me kohë dhe të njëjtit i janë dërguar MPB-së nga ana e Komisionit Komunal për ri-integrim të personave të riatdhesuar.

Investimet kapitale dhe projektet të tjera:

Lista e projekteve për komunitete e cila paraprakisht është aprovuar nga përfaqësuesit legjitim të komuniteteve në koordinim me ZKKK-në, është miratuar në mbledhje të Komitetit për Komunitete e cila është mbajtur me 26.02.2016. Në fillim të muajit mars ZKKK-ja listën e projekteve i ka dërguar edhe drejtorive kompetente.

Projektet e realizuara janë si në vijim:

Në bashkëpunim me IOM-in është realizuar projekti i ndërtimit të terrenit sportiv në Hoçë të Madhe, në të cilin ZKKK-ja është bashkë financues me 3000. €. Ndërsa vlera totale e projektit ka qenë 14,988. €.

Projekti i riparimit dhe vendosjes së ndriçimit të ri rrugor në disa pjesë të Hoçës së Madhe dhe në lagjen e epërme të qytetit. Vlera e projektit është 1,

Pastrimi dhe rregullimi i kanalit kullues të ujërave atmosferike në lagjen e fshatit Xërxë, ku jetojnë anëtarët e komunitetit R.A.E. Vlera e projektit 3,612. €.

Riparimi i rrugës “Boro Vukmiroviç” në lagjen e epërme të Rahovecit. Vlera e projektit 5,785. €.

Ndërtimi i murrit mbrojtës në pjesën e rrugës “Boro Vukmiroviç”. Vlera e projektit 602,50. €.

Ndërtimi i murrit dhe teatrit veror në oborrin e objektit “Saraj” në Hoçë të Madhe. Vlera e projektit 39.354. €.

Projekti është bashkë financuar nga ana e MK-së, në vlerë 19.354. €.

Projekti i zgjidhjes së përherëshme të shtratit të lumit dhe trotuarit në Hoçë të Madhe. Projektin në përgjithësi është financuar nga zyra e Kryeministrit për çështjet e komunitetit, në vlerë prej 47,000. €.

Në këtë periudhë ZKKK-ja në bashkëpunim me këshillin e fshatit e kanë rregulluar çështjen e furnizimit me ujë të pijshëm të fshatit Hoçë e Madhe me kompaninë regjionale të ujësjellësit “Radoniqi”, nga Gjakova. Në fazën e parë kompania obligohet që të merr në menaxhim ujësjellësin lokal dhe të siguroj furnizim pa pengesë. Kompania po ashtu merr mbi vete ndërrimin e ujëmatësve të prishur dhe të bëjë riparimin e rrjetit të kanalizimit si dhe ta zgjidh çështjen e kolektorit të ujërave të zeza. Në fazën e dytë kompania do ta kyç fshatin në sistemin e ujësjellësit regjional, gjë e cila i mundëson fshatit furnizim me ujë kualitativ. Kompania e ka përgatitur projektin, për momentin po mundohemi të sigurojmë mjete për realizimin e tij. 40% e mjeteve do ti siguroj kompania ndërsa pjesa tjetër e 60% të mjeteve duhet ti siguroj komuniteti. Me këtë rast, me kërkesën tonë, kompania e ka punësuar një punëtor i cili do ta kryej pagesën e ujit të shpenzuar dhe i cili do të kujdeset për sistemin e furnizimit me ujë.

Në muajin shkurt IOM-i ka hapur konkurs për Programin për stabilizim të komunitetit. Projekti ka qenë i hapur për projektet individuale për komunitete. Projektet individuale për vetëpunësim janë financuar deri në 4,000. €. Për shkak të kushteve të vendosura (regjistrimi i firmës, punësimi i punëtorit etj), përgjigja ka qenë e vogël. Nga afro 30 kërkesa, është aprovuar vetëm një. Nga projektet e komuniteteve është aprovuar dhe realizuar projekti i lartë përmendur, ndërtimi i terrenit sportiv në fshatin Hoçë e Madhe.

Buxheti dhe puna e Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe është rregulluar në këtë periudhë. Buxheti i këshillit të fshatit përkohësisht i është derdhur buxhetit të ZKKK-së pasi që ministria e financave për momentin nuk ka pasur mundësi të caktoj kodin e veçantë për këshillin e fshatit.

Mbetet problemi i përpilimit të planit rregullues dhe konservatorë për Hoçën e Madhe i cili është i nevojshëm urgjentisht, në mënyrë që këshilli të ketë besueshmëri gjatë marrjes së vendimeve. Problemi është paraqitur në Qeverinë e Kosovës dhe Ministrinë kompetente, ku na është dhënë premtimi i ndihmës në përpilim.

Qasja e komunitetit në shërbime është pa pengesë dhe zyra po mundohet që ti informoj të gjithë komunitete në njëjtën kohë për aktivitetet e komunës dhe Qeverisë, që në mënyrë të drejtpërdrejt apo tërthorazi ju takojnë atyre.

Gjatë muajit prill, sikurse çdo vit, në bashkëpunim me drejtorin për tatimin në pronë, ZKKK-ja ka pranuar ankesat e qytetarëve drejtuar kësaj drejtorie. Janë pranuar 23 ankesa të cilat i janë dorëzuar drejtorisë për tatim. Në gjysmën e muajit maj kemi dal në terren dhe kemi bërë vlerësimin e objekteve në bazë të së cilës janë marrë vendimet për vlerën e tatimit në pronë.

Janë afro dy vite që ZKKK-ja punon me kapacitet të zvogëluar. Mënyra se si është organizuar zyra momentalisht funksionon me vështirësi dhe nuk mund ti përgjigjet të gjithë punëve dhe obligimeve, gjë e cila ka ndikuar në krijimin e pengesave gjatë kryerjes së detyrave dhe aktiviteteve të rregullta.

Problemet më të mëdha janë: mungesa e hapësirës adekuate për punë normale (ZKKK-ja punon në zyre me hapësirë 3X2 m), sistemimi jo adekuat i stafit brenda vetë zyrës (harmonizimi i vendeve të punës në bazë të rregullores nr. 02/2010, për ZKKK-në dhe katalogut të ri për sistemimin e vendeve të punës) dhe mungesa e automjetit zyrtar.

Pavarësisht kërkesës për zgjidhjen e problemit të ZKKK-së, të cilin e kemi dërguar dy herë këtë vit udhëheqësve komunal, nuk kemi gjetur mirëkuptim dhe interesim për zgjidhje të problemit.

RAPORTI VJETOR I PUNËS SËDREJTORISË PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM JANAR-DHJETOR 2016 Z.AVDULLAH KRYEZIU

Organogrami i Drejtorise per Ekonomi Zhvillim dhe Turizem



Aktivitetet e përgjithshme:

Gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore, Drejtor ati për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, ka kryer një varg të detyrave dhe aktiviteteve të parapara për këtë periudhë raportuese.

Auditori i brendshëm ka dhënë rekomandime për punën dhe dobësitë që e kanë shoqëruar këtë drejtori gjatë vitit 2014 , 2015. Të gjitha rekomandimet e auditorit janë marrë seriozisht, janë ndërmarrë masa që të gjitha këto vërejtje dhe të gjetura të auditorit të evitohen, dhe të përmirësohen ne vitin 2015,dhe ne gjashtë mujorin e parë te vitit 2016.

Mbështetur në Ligjin për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144, në rregulloren QRK Nr. 23/2013 për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme si dhe në Vendimin e Kuvendit Komunal të Rahovecit .

Komisioni Vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë, ka mbajtur (2) takime:

➤ **Takimi i parë me këtë rend dite.**

Përcaktimi i kriterëve për shpalljen e ankandit publik “Për dhënien me qira të pesë vikend shtëpizave të ura e shenjte” Xërxë “

Komisioni unanimisht aprovon këtë propozim për dhënien me qira në afat 13 vjeçar, nga data e nënshkrimit të kontratës, si dhe kriteret tjera sipas dosjes së Ankandit.

➤ **Takimi i dytë me këtë rend dite:**

Hapja e ofertave për ankand publik, dhe vlerësimi i ofertave , për dhënien me qira të pesë vikend shtëpizave të ura e shenjte” Xërxë.

Zyrtari për zhvillim

Duke u bazuar në bazën e shfrytëzimit të Lokaleve dhe Pronës Komunale për periudhën Janar –Dhjetor-2016.

Të hyrat dhe Ngarkesa e Sektorit për Zhvillim Ekonomik 2016

Tab-1

Nr	Përshkrimi i të hyrave	Vlera /€
1	Të hyrat nga Qiraja	59,541.21 €
2	Borxhe të falura nga K.K. Rahovec - 50%	31,008.05 €
3	Të hyrat nga Vazhdimi i Orarit të punës për Hotele - Dasma dhe Ahengje	1,260.00€
4	Gjithsejte të hyrat dhe borxhet e falura për vitin 2016 janë:	60,801.21 + 31,008.05 = 91,809.26 €
5	Saldo e mbetur	47,302.84 €

Pëlqim Pune të lëshuar janë gjithsejte; **103 - Pëlqim Pune.**

Me datë 28.01.2016, janë mbajtur dy takime informuese me bizneset që operojnë në komunën e Rahovecit në lidhje me aplikimin në Grande të ARDA-së, janë para kualifikuar dhe pritet aprovimi i fundit nga zyra e BE-së për pesë(5) biznese në Komunën e Rahovecit në vlerë të përfuturit prej - **47,735.00 €.**

Tab-2

Nr.	Aplikanti	Rajoni	Komuna	Lot	Shuma
1.	ISMAIL SHARKU	South	Rahovec	1	4,345.00
2.	RINOPLAST	South	Rahovec	2	9,240.00
3.	DPT ART FASHION	South	Rahovec	3	12,700.00
4.	SYLKA SHPK	South	Rahovec	3	16,450.00
5.	ALBULENA BYTYQI	South	Rahovec	1	5,000.00
	Gjithsejtë				47,735.00 €

Në periudhën Janar – Dhjetor të vitit 2016, duke u bazuar në Rregulloren për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale 01.Nr.238.dt.30.01.2015, nenin 21.4d, janë lëshuar **39 vërtetime**, për dëshmi për kontributin e stazhit të pensioneëve për bizneset e regjistruara para luftë.

Gjate muajit maj, gushte dhe nëntor janë dërguar vërejtje për **30** shfrytëzues të pronës komunale.

Ankandi Publik për pesë vikend shtëpizat të Ura e Shenjte- në muajin Prill-2016

Ri shpallja e ankandit publik për pesë vikend shtëpizat te Ura e Shenjte në muajin Maj-2016,përfitues sipas kriterëve të ankandit është Restoranti “Ura e shenjtë”

Duke u bazuar ne Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit nr.03/L-048,si dhe Rregulloren e MF-NR.02/2013,Për menaxhimin e pasurisë, Jo Financiare në Organizatat Buxhetore, sigurimin efektiv, mbajtja e sakte e të dhënave mbi pasurit e Komunës;

Në periudhën Janar – Dhjetor të vitit 2016, me propozim te Drejtorisë dhe me Vendim të Kryetarit janë

formuar Komisionet:

1.Komisioni për inventarizimin e pasurive jo financiare.

nr. prot.114 dt.15.03.2016

2.Komisioni për vlerësimin e pasurive jo financiare, nr.prot.115,dt.18.03.2016.

3.Komisioni për vlerësimin e palujtshmerive,nr.prot.357 dt.02.08.2016.

Për periudhën Janar-Dhjetor-2016 ne Zyrën e Qendrës komunale për regjistrimin e bizneseve (Q.K.R.B) janë

te regjistruara ne protokoll-235 biznese të reja, janë shqyrtuar gjithsejtë 586 lëndë.

Tab-3

N.R.	PËRSHKRIMI	NUMRI I LËNDËVE
1	REGJISTRIME TË BIZNESEVE TË REJA	235
2	Shuarje të Bizneseve	149
3	Informata të Bizneseve	53
4	Ndryshime të Bizneseve	64
5	Certifikata Dublikatë	10
6	Vërtetime të ndryshme	3
7	Ndërrim I Certifikatës UNMIK-RKS	34
8	Numri Fiskal	0
9	Kërkesë për ndërrim Pronari	8
10	Konfirmim për ATK	18
11	Shuarje(ndërrim Pronari),ose forma e biznesit	12
	GJITHSEJ	586

Raporti i pagesave -Janar –dhjetor-2016-QKRB-ARBK

Tab-4

Muaji:	Numri I fletëpagesave	shuma-totale	vërejtje
janar	Dymbëdhjetë (12)	22,50 €	
Shkurt	Dhjetë (10)	51.50 €	
Mars	Trembëdhjete (13)	58.40 €	
Prill	Katërbëdhjetë (14)	51.50 €	
Maj	Trembëdhjete (13)	56.80 €	
Qershor	Njëzet e tre (23)	75.70 €	
Korrik	Tetë (8)	35.90 €	
Gusht	Nëntë (9)	38.60 €	
Shtator	Tetë (8)	33.00 €	
Tetor	Dhjetë (10)	38.30 €	
Nëntor	Gjashtë(6)	22.30 €	
Dhjetor	Pesë (5)	19.90 €	
Gjithsej	Nr. fletëpagesave - 131	504.4 €	

Vërejtje: Këto mjete nuk janë të hyra komunale, por te MTI-së (ARBK)

ZYRTARI PËR TAKSA AFARISTE KOMUNALE:

1. Është bërë Regjistrimi i te gjitha subjekteve afariste prej librit kryesor të vitit 2015 dhe regjistrimi në librin e ri të vitit 2016, gjithsej me nr. **(AK prej 01 deri 1890)**. Është bërë edhe regjistrimi dhe kalkulimi i ngarkesave për vitin 2016 në formë elektronike.
2. Verifikimi i bizneseve aktuale të cilat nuk kanë mundur të verifikohen në vitin 2015 dhe regjistrimi i bizneseve të reja mbi 130 biznese të reja janë regjistruar 2016.
3. Është bërë shpërndarja e Aktvendimeve ne shumicën e bizneseve mbi 80%, është kryer shpërndarja apo me numër 1,000 aktvendime.
4. Sipas gjendjes aktuale ne te dhënat qe kemi ne formë elektronike, aktualisht **1,337** biznese janë aktive deri ne këtë gjashtëmuor.

5.Inkasimi të Taksave Afariste Komunale Janar-Dhjetor-2016

Tab-5		VITI 2015	VITI 2016	
NR'	MUAJT	SHUMA	SHUMA	DIF. 2016-2015
1	JANAR	5690.00	3201.00	-2,489.00
2	SHKURT	8041.00	9348.00	1,307.00
3	MARS	9356.00	20576.00	11,220.00
4	PRILL	4175.00	7919.00	3,744.00
5	MAJ	4644.00	6676.00	2,032.00
6	QESHOR	10921.00	2936.00	-7,985.00
7	KORRIK	11974.50	6396.00	-5,578.50
8	GUSHT	12664.00	5511.00	-7,153.00
9	SHTATOR	4561.00	2817.00	-1,744.00
10	TETOR	17633.50	9656.00	-7,977.50
11	NENTOR	7954.00	10672.00	2,718.00
12	DHJETOR	7251.00	4350.00	-2,901.00
	TOTALI	104,865.00	90,058.00	-14,807.00

6. Ngarkesa totale për vitin 2016 është **165,293.00 €**

7. Borxhi (Saldo) i viteve paraprake (2016) **744.553.00 €**

8 .Ngarkesa e vitit 2016 + saldo e vitit 2016 **909,846.00 €**

Propozim ndryshimi i Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale 01.Nr.238.dt.30.01.2015.

Ne rregulloren ne fuqi kanë qenë 105 taksa për veprimtari afariste, janë propozua te largohen 60 taksa afariste kanë mbete edhe 45 taksa afariste, janë liruar bizneset prodhuese tregtare ,transportuese, shërbyese, ndërsa kanë mbete te ngarkuara ,ndërmarrjet publike, regjionalë ,qendrore ,lokale, institucionet financiare, bankat ,PTK,IPKO,KEDS-i,

bizneset qe merren me lojëra të fatit, bizneset te cilat e ndotin ambientin(gurëthyesit , separusit, pompat e derivateve te naftës eksploatuesit e mineraleve, shtëpitë e mallrave ,hipër-super marke tët, ,sallonet e dasmave dhe të mobileve.

Me dt.28 dhjetor Kuvendi Komunal pas vërejtjeve nga Ministrit te cilat bëjnë monitorimin e vendimeve, dhe akteve te Kuvendit, është bere shqyrtimi i rekomandimeve te Qeverisë, lidhur me rregulloren e propozuar dhe me shumicë te votave janë miratuar, dhe janë ndryshuar te gjitha rekomandimet dhe ne vitin e 2017 Komuna do ta ketë Rregulloren e re për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale, 01. Nr.3007 e dt.27.09. 2016,e cila do te jete transparente për Qytetare dhe biznese ne Ueb faqe te Komunës së Rahovecit.

Regjistrimi i pasurisë Komunal Janar-Dhjetor-2016

Regjistrimet e pasurisë mbi-1000 €	Regjistrimet e pasurisë nen-1000 €	Regjistrimi i ngastrave te tokës	Regjistrimi ne E-pasuri	Numri i përgjithshëm I regjistrimeve
124	381	358	48	911
Vlera ne euro	Vlera ne euro	Vlera ne euro	Vlera ne euro	Vlera ne euro
2,344,326.00 €	12,672.14 €	4,803,210.00 €	0,97 €	7,160,209.00 €

Janë përfundua këto projekte :

- | | |
|---|-------------|
| 1.Rregullimi i shtegut deri te Maja e Shkodranit-me vlerë | 15,000.00 € |
| 2.Rregullimi i qendrës së bizneseve ne Rahovec-me vlerë | 12.000.00 € |
| 3.Tregu i kombinuar ne Rahovec ,me vlerë | 32,740.00 € |

TOTALI = 59,740.00 €

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË DREJTORISË PËR PUNËS INSPEKTUESE JANAR-DHJETOR 2016 Z. ADMIR ORUQI

Për periudhën janar-dhjetor 2016,Drejtoria për punët inspektuese ,ka planifikuar të realizoj detyrat e punës ,sipas planit të punës për periudhën Janar-Dhjetor 2016,që burojnë nga ligjet që janë në fuqi, udhëzimet administrative dhe rregulloret KK –Rahovecit sipas departamenteve gjegjëse.

Qellim madhor i këtij planifikimi ,është mbrojtja sa me efikase e interesave të qytetareve të komunës së Rahovecit, në bashkëpunim me të gjitha palët e interesit si :institucionet shtetërore, organet komunale ,komuniteti i biznesit dhe qytetarët.

Drejtori i drejtorisë

- Kam menaxhuar punët e drejtorisë për punë inspektuese
- Jam kujdes për mbarëvajtjen e punëve brenda drejtorisë në përgjithësi dhe sipas sektorëve në veçanti;
- Jam kujdes për realizimin e buxhetit;
- Kam mbajtur kontakte te vazhdueshme me Kryetarin e KK Rahovec;
- Kam marr pjesë ne takimet e këshillit të Drejtoreve;
- Kam mbajtur takime të rregullta javore dhe periodike me

inspektoret;

-Kam bërë riorganizimin e grupeve punuese

-Kam përgatitur raportet mujore të punës për vitin 2016.

-Kam përgatitur planin e punës për vitin 2016.

Për gjashtëmujorin e vitit 2016 janë kryer këto punë konkrete:

-Është bërë plani operativ i veprimit në terren i cili nënkupton aksione sipas sektorëve.

-Janë dhënë detyra shtesë inspektorëve për evidentimin e subjekteve të reja afariste në Komunën tonë.

-Janë lëshuar 70 certifikata të therje për 14.130kg mish të damkosur në thertoret e licencuara nga AUV-së.

-Është përfunduar aksioni dhe inspektimi i të gjitha furrat e bukës, kontrolli i pikave shitëse të derivateve, janë kontrolluar subjektet afariste të pa regjistruara në MTI si dhe janë obliguar të pajisen me pëlqen pune për ushtrimin e veprimtarisë.

-Në muajin Janar kemi ndërmarr aksion për inspektimin e të gjithave barnatoreve humane që veprojnë në territorin e KK-Rahovecit.

- Është kryer inspektimi i të gjitha objekteve shkollore në tërë territorin e Komunës së Rahovecit, janë inspektuar(kushtet higjienike momentale të hapësirave brenda shkollave, janë evidentuar mungesa të theksuara për të cilat është njoftuar edhe Drejtoria Arsimit), janë inspektuar edhe të gjitha objektet e QMF-së dhe të AMF-së.

- Është përfunduar me sukses aksioni i kontrollimit dhe inspektimit të kompanive të cilat bëjnë shitjen me shumicë dhe pakicë produkteve të mishit, ky inspektim është përfunduar në bashkëpunim me inspektorët e AUV-së.

- Janë mare 3 mostrat për analiza sipas planit kombëtar vjetor.

-Inspektorët e sektorëve të ndryshëm kanë kryer inspektime në Potoqan të Ultë dhe Dejnë me rastin e festës së Shëngjergjit .

-Inspektim i jashtëzakonshëm me Policin në Dejnë me rastin e Festivalit “Anadrinia Jehonë”.

-Inspektorët e ndërtimit kanë inspektuar objektet ndërtimore me leje ndërtimi dhe pa leje ndërtimi ku pronarët i kanë obliguar që të pajisjen me leje ndërtimi.

-Kanë inspektuar objektet e përkohshme montazh në tërë territorin e Komunës së Rahovecit, ndërtimin e rrugëve, kanalizimet, trotualet, vendosjen e shtyllave elektrike.

- Janë inspektuar subjekte afariste dhe janë obliguar që të lidhin kontratë me operator për grumbullimin e mbeturinave, inspektimet e përbashkët me inspektor të Ministrisë departamenti i Minierave dhe Mineraleve.

-Inspektori i komunikacionit është angazhuar që të inspektoj të gjitha kompanitë transportit të udhëtarëve linjat ndër-urbane, ka inspektuar të gjitha auto-taksitë që veprojnë në Komunën tonë.

- Inspektori për çështje komunale ka qenë i angazhuar të kryej inspektime në shfrytëzimin e hapësirave publike etj.

-Është marr të gjithat masat e nevojshme për sëmudjen gungore të lopëve, hedhja e kafshëve ne gropën septike e deri te eliminimi i tyre. Gjithsej kane ngordh 22 lope.

-Është marr të gjitha masat për eliminimin e objekteve, që paraqesin rrezik permanent për të gjithë qytetaret të Komunës së Rahovecit.

Për këtë periudhë inspektorët kanë kryer këto punë:

➤ Inspektimet të planifikuara	5285.
➤ Inspektimet të realizuara	5517
➤ Procesverbale	5121
➤ Aktvendime	381
➤ Fletëparaqitje në gjykatë	114
➤ Njoftime	29
➤ Kërkesa	138
➤ Ftesa	4
➤ Palët të dënuar në gjykatë	28

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË DREJTORISË PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME JANAR-DHJETOR 2016 Z. SALI SALLTEKU

Në kuadër të kësaj drejtorie funksionojnë këta sektorë:

1. **Spektori për Administratë të Përgjithshme**
2. **Spektori për punë të Kuvendit dhe Komiteteve**
3. **Spektori për Gjendjen Civile**
4. **Spektori për Mirëmbajtje, Logjistikë dhe Sigurim të Objekteve**
5. **Spektori për barazi gjinore, të drejtat e njeriut dhe integritime evropiane dhe të drejtat e fëmijëve.**
6. **Spektori për teknologji informative.**

Raporti përfshinë në pikat e shkurta punët të cilat i kemi kryer brenda drejtorisë të Administratës së Përgjithshme sipas sektorëve.

Po ju paraqesim projektet kapitale të realizuara nga kjo drejtori, për periudhën Janar – Dhjetor 2016

1. Furnizim me pajisje të teknologjisë informative 5000 €
2. Njëpër qendrat për shërbime të qytetarëve dita ditës është duke u përmirësuar shërbimi ndaj qytetarëve, falë modernizimit të teknologjisë.
3. Në Krushë të Madhe është në përfundim e sipër ndërtimin i objektit të ri të Gjendjes Civile, projekt i cili kushton afro 50.000 €.
4. Është përfunduar luterja e hapësirave në ndërtesën e re të komunës, projekti i cili kushtoi 10000 €
5. Është në përfundim e sipër projekti i Bufesë në objektin e ri të komunës, projekt i cili ka koston 15000
6. Pastrimi dhe mirëmbajtja e objektit të komunës.
7. Janë bërë disa investime të vogla në meremetimin e objektit të komunës.

SEKTORI PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME

Raporti për periudhën: Janar – Dhjetor 2016

- Është mbajtur takimi me të gjithë punëtorët e drejtorisë për Administratë të Përgjithshme, qëllimi i këtij takimi ka qenë njoftimi mes drejtorit dhe stafit.
- Kontrollimi i të gjitha zyrave të gjendjes civile në terren.
- Kontrollimi i automjeteve dhe përcjellja e servisimeve, dhe karburanteve.
- Mirëmbajtja e objekteve të komunës.
- Formimi i komisionit për ankesa të qytetarëve.
- Vëzhgimi i punimeve gjatë ndryshimeve në infrastrukturë në QSHQ.
- Pjesëmarrja në takime të ndryshme, siç janë: Asambleja Komunale, takimet me bordin ekzekutiv, takime në Asociacionin e Komunave.
- Takimet me kryetarin në lidhje me konsultime për lëshimin e vendimeve të ndryshme.
-

SEKTORI PËR PUNË TË KUVENDIT DHE TË KOMITETEVE

Është marr me angazhime të ndryshme brenda kompetencave. Ka ndërmarr të gjitha masat për organizimin më të mirë të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës. Ka përgatitë materiale të nevojshme, ka dërguar ftesa dhe është marr me çështje të tjera rreth organizimit të mbajtjes së Kuvendit.

- Është mbajtur procesverbali në mbledhje nga mbledhjet e Kuvendit
- Organizimi i mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës
- Organizimi i mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa
- Nxjerrja e vendimeve, aktvendimeve, urdhëresave
- Dërgimi i të gjitha akteve në MAPL sipas kërkesës së tyre
- Sistemimi i materialeve në dosjet e arkivit
- Janë realizuar përkthime të ndryshme sipas nevojës

- Është vënë në debat publik ndryshimi dhe plotësimi i Statutit të Komunës
- Janë kryer edhe punët tjera sipas urdhrin të kryesuesit të Kuvendit, kryetarit të komunës dhe kërkesave të drejtorëve të drejtorive e veçanërisht të drejtorit të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme.

SEKTORI PËR GJENDJE CIVILE

Sektori për Gjendje Civile kryesisht merret me kërkesat e qytetarëve në lidhje me lëshimin e dokumenteve të gjendjes civile, dhe më poshtë po ua përshkruajmë raportin e të hyrave nga ky sektor për periudhën Janar –Dhjetor 2016

Të hyrat nga ky sektor për periudhën Janar – Dhjetor 2016 janë inkasuar përafërsisht mbi 70.000 € ndërsa për vitin 2016 ky sektor ka planifikuar të hyrat prej 88.000 €.

Ky sektor dita ditës është duke i kryer shërbimet në mënyrë shumë më efektive duke iu falënderuar modernizimit të sistemeve dhe aplikacioneve dhe gatishmërisë së stafit.

Ky sektor përveç sistemit të vijueshmërisë në punë synon instalimin e një aplikacioni intern për sektorin e vet për mbikëqyrjen e stafit të vet dhe matjen e performancës së punëtorëve.

Në këtë vit nuk kemi pasur probleme me furnizim me certifikata të gjendjes civile, siç kemi pasur viteve të mëhershme.

Gjatë këtij viti në bashkëpunim me sektorin e Teknologjisë kemi planifikuar dhe jemi në përfundim të furnizimit me kamera për zyrat e gjendjes civile, të cilat edhe do të i vendosim në fillim të vitit.

SEKTORI PËR MIRËMBAJTJE, LOGJISTIKË DHE SIGURIM TË OBJEKTEVE

Brenda kompetencave ka kryer punët rutinë pa ndonjë specifik.

Ky sektor është marrë me rregullimin e çështjeve logjistike (pastrim, kujdes për gjelbërim etj.). Gjatë kësaj periudhe nuk është shënuar ndonjë incident.

SEKTORI PËR BARAZI GJINORE, TË DREJTAT E NJERIUT DHE INTEGRIME EVROPIANE DHE TË DREJTAT E FËMIJËVE

Me Udhëzimin Administrativ –MAPL – Nr. 2008/02 për themelimin e Njësive për të Drejtat e Njeriut në Komuna, edhe me Statutin Komunal është paraparë themelimi i NJDNJ, si mekanizëm i qëndrueshëm dhe përgjegjës për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivelin komunal, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe politikat e institucioneve të Kosovës.

Kjo zyrë, si pjesë e institucionit komunal merret me aktivitetet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe përkrahjen e të drejtave të njeriut e në veçanti të grave (duke marrë parasysh se në përgjithësi në Kosovë gratë janë më të cenuar) të drejtat e fëmijëve dhe dhunën në baza gjinore, në përkrahjen e projekteve të arsyeshme të OJQ-ve në promovimin e barazisë gjinore, aktivitetet e grumbullimit të dhënave bazuar në moshë, gjini dhe etni të grupeve (komuniteteve), rastet e dhunës në familje, bashkërendimin e punëve dhe bashkëpunimin e mirëfilltë me të gjitha drejtoritë që prekin në fushën e barazisë gjinore e sidomos me QPS ,këshillimin për rastet e grave të ndara nga bashkëshortët, lidhur me përfitimin e ndihmave sociale, krijimin e partneritetit me subjektet relevante në komunë ,etj.

Aktivitetet e kësaj zyre në kuadër të NJDNJ gjatë vitit 2016 janë të shumta:

Kjo NjDMj tani ka Koordinatorin për të Drejtat e Njeriut dhe 3 zyrtar: (zyrtar për Barazi Gjinore, zyrtar për Integritet Evropiane ,zyrtar për të Drejtat fëmijëve) ,

*Kërkesa për Barna Gjithsej 2 kërkesa të aprovuara , një kërkesë është vazhduar dhe një kërkesë e re është aprovuar.

* Kërkesë për Akomodim gjithsej 6 kërkesa të aprovuara.

* Kërkesa për Dru zjarri gjithsej 13 , të aprovuar 12 në vlerë të 200€ , të refuzuar 1

*Kërkesa për ndërtim të shtëpive gjithsej 5 gjatë vitit 2013 të aprovuara 4 ndërtime të shtëpive (2 shqiptar dhe 2 serb), një e refuzuar, ndërtimet janë realizuar në vitin 2014 gjithsej 2 shtëpi dhe 2 shtëpi janë në realizim .

* Kërkesa për Plan Biznesi gjithsej 11, të aprovuar 7 kërkesa në vlerë 2000€ , 4 të refuzuar .

SEKTORI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE

Ky sektor merret me mirëmbajtjen e rrjetit, pajisjeve të teknologjisë informative, menaxhimin e aplikacioneve, mirëmbajtjen e ueb faqes si dhe punë tjera.

Në këtë sektor janë kryer shumë veprimtari, më poshtë po i cekim në pika të shkurta:

- Janë kryer punët e përditshme, mirëmbajtja e rrjetit, serverëve, zyrat e gjendjes civile (zyrat e vendit), mirëmbajtja e ueb faqes, krijimi i backupa-ve nga serverët etj.
- Janë zbatuar urdhëresat e lëshuara nga kryetari dhe drejtorët.
- Krijimi i llogarive në domain qeveritar, si dhe krijimi i emailave zyrtar, përditësimi i tyre.
- Zhvillimi i takimeve të ndryshme, takime sipas ftesave në institucione qendrore etj.
- Përkrahja në takime të ndryshme të mbajtura në sallën e kuvendit, incizimi i këtyre takimeve.
- Rregullime harduerike në pajisjet e TI-së në institucionet komunës sonë.
- Azhurnimi i porteve, IP-ve në rrjetin e brendshëm të komunës.
- Punimi i aplikacioneve të ndryshme në paketën e MS OFFICE me kërkesa nga drejtorët.
- Përkrahje të vazhdueshme stafit të komunës.
- Përkrahja e shkollave me kërkesa të tyre, në mirëmbajtjen e pajisjeve të TI-së.
- Punimi i paramasave dhe parallogarive për projektet furnizimi me pajisje të teknologjisë informative, dhe furnizimi dhe montimi i kamerave.
- Kemi pasur problem serioz me rrjet në komplet institucione të komunës sonë, shkak i djegies së pajisjeve transmetuese në Zatriq, ku pas kësaj është lidhur fija optike dhe nëpërmjet kësaj fije jemi lidhur në rrjetin shtetëror.
- Në bashkëpunim me MAPL-në kemi bërë përgatitje për instalimin e sistemit të ri të intranetit, po ashtu po bëhen përgatitje të bëhen edhe ridizajnimet e webfaqeve.
- Po ashtu në dy javët e fundit të muajit dhjetor kemi problem me webfaqen e komunës, problemi është gjeneral nga MAPL-ja.

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË DREJTORISË PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE JANAR-DHJETOR 2016 Z. MUNIB DURGUTI

Aktivitetet e DSHMS-së për periudhën raportuese janë:

- Konsultimet dhe takimet e rregullta me stafin, Drejtorin e QKMF-së si dhe Drejtorin e QPS-së me qëllim të përmbushjes së objektivave të përcaktuara.
- Përpilimi i raporteve të punës për vitin 2016, dhe krijimi nevojës për raportim të vazhdueshëm,
- Angazhimi rreth përmirësimit të kushteve për punë të nëpunësve dhe stafit në përgjithësi në kuadër të DSHMS-së,
- Shqyrtimi dhe përgjigja me kohë në kërkesat e ndryshme të qytetarëve si dhe të atyre për ndihmë momentale-financiare,
- Pjesëmarrja aktive në kolegjiun e drejtorëve të DSHMS-së, në cilësinë e anëtarit të kryesisë në kuadër të Asociacionit të Komunave, 1.shqyrtuar statutin e QKMF-ve të sponsorizuar nga MSH,
- 2.unifikimi,ndryshimi i rregulloreve për subvencione, dhe 3.blerja e shërbimeve sociale nga organizatat joqeveritare nga vendoret dhe ndërkombëtares, ishin ndër aktivitetet kyçe në vitin që e lamë pas.
- Pjesëmarrja dhe mbështetja e aktiviteteve të rëndësishme e veçantë: Dhurimi vullnetar i gjakut në Rahovec, Denje, shënimi i ditës botërore të infermierisë, në bashkëpunim me OJQ-te në aktivitete të ndryshme informuese për të rrejnë në luftimin dukurive negative; Duhanit, Narkotikeve etj.

- Takimi me Ministrin e MSH z. Imet Rrahmani lidhur me funksionalizimin e Qendrës së Dializës, shqyrtimin e mundësisë për mbështetjen e komunës së Rahovecit në projektin ‘‘Home Care’’ nga Ministria e Shëndetësisë si dhe Mungesa e Personelit shëndetësor në komunën tonë.
- Trajnimi i personelit shëndetësor ne Qendrën e Dializës në Prizren- ka përfunduar trajnimi në periudhë kohore nga dt.01.06.2016 - 30.11.2016 me ç ‘rast personeli është certifikuar ku janë aftësuar ne profesionin e vetë për kryerjen e punëve dhe detyrave të punës në hemodialize.
- Në emër të shpenzimeve të trajnimit të personelit, shpenzimeve të udhëtimit si dhe angazhimit të vozitësit për bartjen e personelit Meditech-u do ti transferoj mjetet Komunës së Rahovecit në kodin mallra dhe shërbime.
- Me qëllim të stimulimit të tyre dhe mbulimit të shpenzimeve do të paguhen me shtesa:

Përbërja e personelit shëndetësor si vijon:

Stafi	Nr	Shpenzimet mujore	Muaj	Totali
Teknik	5	100.00	6	3,000.00
Inxhinier elektros	1	100.00	6	600.00

- Takime me përfaqësues të ‘‘ Caritas Kosova’’ lidhur me përtëritjen e marrëveshjes së bashkëpunimit të ashtuquajtur Home Care - Kujdesi Shtëpiak, në këtë drejtim kemi arritur një marrëveshje bashkëfinancimi ku komuna jonë është përfituese e këtij programi edhe për vitin 2016, numri i punëtoreve shëndetësor të përfshirë në këtë marrëveshje bashkëfinancimi është 30 .

Realizimi i marrëveshjes me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Caritas Kosova home care-kujdesi shtëpiak është në vlerë prej 90.000 €.

Komuna e Rahovecit-60.000€, Ministria e Shendetesise-20.000 € dhe Caritas Kosova-10.000€.

- Takime me organizata joqeveritare-OJQ lokale, me qëllim të ngritjes së nivelit të bashkëpunimit dhe koordinimit ndër-institucional dhe të profesionistëve përgjegjës siç janë: Hendikosi, Humaniteti, Opfakosi, Hareja, Iniciativa Pozitive, Qendra Rinore etj.
- Mbështetja e projekteve sociale të cilët janë ofruar nga OJQ-të lokale në vlerë prej **9,090.00 €**, janë përkrahur **5 OJQ** të cilat kanë ofruar projekte konkrete.
- Pjesëmarrja e rregullt në punëtori (me stafin e QPS-së) për ‘‘Shërbimeve Sociale Cilësore në Komunitet’’ , organizuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në bashkëpunim me zyrën BE-se ne Kosove ‘‘Mbështetje për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale në forcimin e mekanizmave për implementimin e decentralizimit të shërbimeve sociale.
- Koordinimi dhe bashkëpunimi me Agjensionin e Veterinës dhe Ushqimit në zbatimin e projektit ‘‘Repelimi i kafshëve shtëpiake’’ në territorin e komunës së Rahovecit.
- Duke marrë për bazë që komuna jonë është një ndër vatrat e prekura me ethet hemorragjike, me kohë kemi bërë planifikimin e projektit për Ethet Hemorragjike Krime Kongo-EHKK, ku është formuar këshilli organizativ multisektorial nga personeli shëndetësor dhe jo shëndetësor (ekipe për marrjen e masave parandaluese kundër EHKK), i cili projekt ka filluar dhe pritet të zbatohet edhe ne muajt ne vijim.

- Pjesëmarrja në takime të Këshillit ndër-ministror për luftimin e EHKK i kryesuar nga Ministri i Shëndetësisë me qëllim të koordinimit të aktiviteteve, zbatimit të strategjisë si dhe marrjen e përgjegjësisë nga komunat endemike konformë UA nr.02/2015.
- Dezinsektimi Dezinsektimi dhe Deratizimi në dy faza i të gjitha institucionet komunale (shkollat, çerdhja e fëmijëve, Tulipanët,, në Rahovec, institucionet publike Komunale dhe shëndetësore).
- Janë kryer vizitat sistematike stomatologjike nga mjek stomatolog dhe tek.med për nxënësit nga parashkolloret deri te nxënësit e klasës së IX, këto vizita sistematike janë konsideruar si tejet të rëndësishme për shëndetin e fëmijëve-nxënësve tanë.
- Takim me përfaqësuesit e dy organizatave Developing Together si dhe KAAD-i lidhur me projektin e **Banimit Social** (banesa kolektive), projekti i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga përfaqësuesit e zyrës së BE-së.
- **Shëndeti Publik:** Në kuadër të Drejtorisë komunale të Shëndetësisë ekziston edhe shërbimi për mbrojtjen e shëndetit publik i cili kujdeset për mbrojtjen e shëndetit të popullatës pa dallime etnike, race, moshe, gjinie etj. sikurse edhe shërbime të tjera. Kjo realizohet përmes promovimit dhe edukimit shëndetësor nëpër shkolla dhe institucione tjera si dhe përmes punës me komunitetin. Ky shërbim bënë monitorimin edhe të sëmundjeve ngjitëse dhe imunizimin. Vaksinat sigurohen nga Instituti Kombëtar për Shëndetin Publik.
- Janë evidentuar dhe shpërndare gjithsejtë **1815 thirrje-ftesa** për vaksinimin e fëmijëve në komunën tonë.
- Përpilimi shkresave te ndryshme zyrtare(vendime, njoftime, propozime, autorizime etj. gjithsej 118).
- Takim pune me përfaqësuesit e Shoqatave të dala nga Lufta ,vazhdimi i bashkëpunimit me këto kategori dhe caktimi i takimeve të rregullta mujore në mes të DSHMS-se dhe kryesisë së shoqatave,
- Pjesëmarrje në komisione të ndryshme,
- Komisioni për ndarjen e ndihmave momentale-financiare ka shqyrtuar kërkesat dhe janë aprovuar dhe refuzuar si me poshtë:

Nr.i kërkesave për ndihmë momentale-financiare	Miratuara	Refuzuara	Gjithsej
	231	119	350

- Gjatë kësaj periudhe ne maternitet janë kryer gjithsej këto lindje:

Komuna e Rahovecit	Komuna e Malishevës	Gjithsej
119	27	146

- Lëshimi i vërtetimeve për familjar te personave të vrarë, zhdukur, dëshmor, të plagosur, gjithsejtë **91 vërtetime**, si dhe janë vërtetuar **201 formular** për punëtorët tanë që përkohësisht punojnë dhe veprojnë në shtetet tjera, të cilët gëzojnë të drejtën në shtesat fëmijërore në vendin ku punojnë dhe veprojnë.
- Plotësimi i **45 formularëve(aplikacioneve)** për shërim jashtë vendit në bazë te udhëzimeve të QKUK-së (komisioni mjekësor) dhe janë udhëzuar palët ta dorëzojnë aplikacionin në Ministrinë e Shëndetësisë.

Pasqyra tabelare dhe grafikoni të numrit të familjeve dhe mjeteve të ndara për ndihmë sociale:

Nr.	Muajt	Numri i familjeve	Shuma e mjeteve
1	Janar	736	68332,50
2	Shkurt	755	70395,50
3	Mars	768	71098,75
4	Prill	740	68046,25
5	Maj	740	68442,50
6	Qershor	745	68602,50
7	Korrik	728	67196,25
8	Gusht	706	65680,00
9	Shtator	712	65825,00
10	Tetor	714	65930,00
11	Nëntor	706	64870,00
12	Dhjetor		

INVESTIMET KAPITALE DHE DONACIONET 2016.Projekti me Bashkëfinancim Caritas Kosova –Komuna Rahovec –Ministria e Shëndetësisë Total Projekti 90,000.00 Euro te punësuar 31 Punëtor shëndetësor , 4 Mjek 2 stomatolog 25 infermier.

Participimi nga Komuna Rahovec 60,000.00 ,Ministria e Shëndetësisë 20,000.00 dhe Caritas Kosova 10,000.00

2.Auto Ambulanca për Bartjen e pacienteve ne Dialize vlera 24,680.00

3.Ndertimi i Ambulancës në f.sh Malësi e Vogël Vlera e Projektit 60,089.20 Kontrata 2 vjeçare janë kryer 95% të punimeve ne vitin 2016, ndërsa pjesa e mbetur do të vazhdoj në 2017.

4.Renovimi i QKMF-se Rahovec Vlera e projektit 127,809.59 Kontrata dy vjeçare,(2016-2017) në kuadër të këtij Renovimi është përfshirë edhe Rregullimi i Repartit të Dializës.

5.Kane përfunduar 2 Faza te Dezinfektimit, Deratizimit dhe Dezinsektimit në Komunën e Rahovecit vlera e Projektit 38,750.00.

Deratizmi është bere ne 32 shkolla dhe shume objekte tjera Komunale dhe Shëndetësore të Komunës së Rahovecit

6.Furnizim me Pajisje Medicinale vlera e Kontratës 32,215.00 Kontratë dy vjeçare (2016-2017)

DONACIONET

1. Përfitimi nga Granti i shpallur nga Ambasada Japoneze për Shëndetësinë në Kosove në vlerë prej 61,116.00 Euro në pajisje medicinale: Karriqa Dentare, Analizatori Hematologjik Analizatori Biokimik dhe Autoambulanca (të gjitha pajisjet janë të reja dhe me origjinë nga vendet evropiane).

2. DShMS-ja pas kërkesës së parashtruar dhe disa takimeve me Drejtorin e ShSKUK-së ka realizuar donacion pajisjen medicinale, zhvillues të rëntgenit (komora), nga ShSKUK-ja Pajisja është gjysme digjitale dhe vlera e pajisjes është rreth 10 mijë Euro.
3. Komuna e Rahovecit dhe kompania “Meditech” kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e projektit “ Trajnimi i Personelit Shëndetësor të QKMF-së, (vlera e donacionit 6.480 euro) në Qendrën Spitalore të Dializës dhe në Repartin nefrologjik në QKUK”.
4. Donacion Caritas Kosova Xhip Hyundai Galoper Vlera 5,000.00 Euro
5. Po ashtu vlen të përmendet edhe kontributi i MSH me 20.000 në marrëveshjen Home-Care.

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË DREJTORISË PËR ARSIM JANAR-DHJETOR 2016 ZNJ. VJOLLCA VUÇITERNA

Synim i përgjithshëm :

- Ngritja e cilësisë së performancës së SHFMU-ve dhe SHML-ve të Komunës së Rahovecit.

Qëllimet :

- Ngritja e cilësisë së procesit edukativo-arsimor në shkollat fillore të mesme të ulëta, të mesme të larta dhe profesionale të Komunës së Rahovecit,
- Përmirësimi i infrastrukturës së brendshme dhe të jashtme shkollore
- Zhvillimi i aktiviteteve të shumta jashtë kurrikulare,
- Përmirësimi i administratës në shkollat fillore dhe të mesme të komunës,
- Përsosja profesionale e kuadrit arsimor.

Objektivat që synohet të arrihen brenda vitit shkollor 2016/2017 :

- Përmirësimi i nivelit të mësimdhënies dhe të nxëniet e nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme të komunës së Rahovecit,
 - Përmirësimi i vlerësimit të nxënësve,
 - Ndërtimi i objekteve shkollore,
 - Renovimi i shkollave,
 - Rregullimi i hapësirave të brendshme dhe të jashtme të shkollës,
 - Zhvillimi i aktiviteteve të shumta jashtë kurrikulare në nivel shkolle dhe komune,
 - Futja në procesin e implementimit të KB dhe KKK për të gjitha shkollat e komunës
 - Bashkëpunimi me komunitetin,
 - Integrimi në procesin edukativo-arsimor i të gjithë fëmijëve të të gjitha komuniteteve pa dallim
 - Kultura e punës vullnetare në shkolla,
 - Zhvillimi i kulturës së lexuesve të rinj në shkolla etj.
 - Sigurimi fizik nëpër shkolla.
- Gjatë vitit shkollor 2015/ 2016 janë mbajtur mbledhje të rregullta mujore mes DKA-së dhe MASHT-it.
- Po ashtu janë mbajtur mbledhje të rregullta me drejtorë të shkollave, duke u raportuar me shkrim rreth gjendjes aktuale në shkollat përkatëse.
 - Është formuar komisioni për vizita sistematike në shkolla, për evidentimin për së afërmi të nevojave dhe kërkesave të shkollave për mbarëvajtjen e procesit edukativo- arsimor dhe rritjes së cilësisë në arsim.
 - Është mbajtur trajnim për drejtor të shkollave me temën” Dhuna në shkolla dhe bartja e te dhënave në programin EMIS” i organizuar nga MASHT.
 - Është mbajtur trajnimi me mësimdhënës për nxënësit në nevojë.

- Trajnim me mësimdhënës në lëndën e matematikes të ciklit të ultë (kl. 1,2,3,4,5) i organizuar nga MASHT dhe DKA.
- Trajnim me mësimdhënës në lëndën e shkencave të natyrës të ciklit të ultë (kl. 1,2,3,4,5) i organizuar nga MASHT dhe DKA (vazhdon).
- Trajnim me edukatoren e ciklit para fillor organizuar nga Caritasi Zviceran.
- Është duke vazhduar trajnimi i mësimdhënësve të shkollave pilot në KB (Kurikukula Bërthamë) dhe KKK(Korniza e Kurikulës së Kosovës).
- Trajtime për mësimdhënës, “Zhvillimi i shkathtësive të leximit në klasat e hershme” dhe “Vlerësimi Formativ” i organizuar nga USAID-i.
- Trajtimi i ekipeve për ngritje të cilësisë në nivel komunal dhe shkolle, ekipet për vlerësim të brendshëm, si dhe koordinatorit të cilësisë në nivel DKA-je, dhe koordinatorëve në nivel shkolle (vazhdon).
- Trajtimi i 15 shkollave në projektin EPRBM, formimi i ekipeve dhe analiza e gjendjes për përpilimin e planit të veprimit për reagim ndaj braktisjes dhe mos regjistrimit të fëmijëve në shkolla.
- Trajnim i mësimdhënësve për administrim të portalit e-shkolla. (Katër shkolla pilot për digjitalizim të ditarit shkollor, - Shkollat me kurrikulë).
- Në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë ligjërata dhe vizita sistematike të mjekëve në shkolla, (kujdesi oral dhe sensibilizimi i nxënësve në shkolla kundër etheve hemorragjike)
- Në bashkëpunim me Policinë e Kosovës janë mbajtur ligjërata dhe vizita sistematike në shkolla, projekti “Delikuenca dhe dhuna ndaj të miturve”.
- Trajnim për komisionin selektues për identifikimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në nivel komunal.
- Organizimi i manifestimit të “7 Marsit” Dita e Mësuesit dhe shpërndarja e mirënjohjeve për mësimdhënës të dalluar.
- Në bazë të kërkesave të nevojave të shkollave janë shpallur konkurse, (zëvendësim lehonash) dhe janë pranuar punëtor.
- Është shpallur edhe konkursi për drejtor të shkollave dhe është bërë përzgjedhja e tyre. (20 shkolla fillore dhe 1 qerdhe).
- GARAT
- Vlerësimi i brendshëm
- Po ashtu janë mbajtur edhe garat komunale në nivel të shkollave dhe atë: më, 13.05.2016, për klasat e treta dhe të pesta të shkollave fillore.
- Më, 14.05.2016, për klasat e VI, VII, VIII, dhe IX- ta, të Shkollave të Mesme të Ulta.
- Më, 16.04.2016, për klasat e X, XI, XII-ta, të Shkollave të mesme të larta (këtë vit për here të pare).
- Gara komunale për olimpiadë të Matematikës dhe Kimisë
- Gara sportive në futboll dhe volejball, për femra dhe meshkuj.
- Është organizuar edhe testi provues për maturantë dhe klasat e nënta.
- Vlerësimi i jashtëm
- Janë mbajtur gara edhe në nivel rajonal nga lënda e Kimisë dhe Gjuhës Angleze nga Kolegji ” Mehmet Akif” ku nxënësit tanë, kanë treguar rezultate dhe janë renditur në 10 vendet e para.
- Po ashtu nxënësit tanë të klasave të nënta kanë marrë pjesë në Kuizin “Eureka 3” ku në mesin e 2000 pjesëmarrësve, 6 nxënës, të komunës sonë kanë arritur në finale.
- Pjesëmarrja e dy nxënësve të gjimnazit “Xhelal Hajda-Toni” në garat ndërkombëtare të Kimisë në Stamboll.
- Pjesëmarrja e 20 nxënësve, të katër shkollave të komunës në “Kursin intensiv të gjuhës angleze” i cili u mbajt në Angli, ku nxënësit janë pajisur me certifikata.
- Garat “Spelling B” të organizuara nga Korpusi i Paqes në nivel qendror të mbajtura në Prishtinë, ku nxënësit tanë kanë zënë vendin e dytë.
- Pjesëmarrja e nxënësve në Olimpiadën e Matematikës.
- Pjesëmarrja e nxënësve në Olimpiadën e Kimisë.
- Pjesëmarrja e nxënësve të ekonomisë në Panairin e firmave ushqimore në Prishtinë.

- Gara të organizuara nga MASHT për klasat e pesta,(2 kl. Shkolla "Isa Boletini" dhe 1 kl." Heronjtë e Kosovës")etj.
 - Më, 21.05.2016, është mbajtur TESTI I ARRITSHMËRISË për klasat e IX –ta.(testimi është realizuar në 4 qendra, 26 shkolla, 52 paralele, 1172 nxënës, 104 administrues dhe vëzhgues).
 - Më, 04.06.2016 dhe 18.06.2016, është mbajtur afati i Qershorit I TESTIT TË MATURËS SHTETËRORE , dhe afati i Gushtit, më 27.08.2016 dhe 03.09.2016.Testimi është mbajtur në 5 qendra dhe kane mare pjese 720 nxënës, 65 administrues dhe vëzhgues.
 - Kalueshmëria e nxënësve në testin e maturës për të dy afatet ka qenë 80.91 %.
 - Në të gjitha shkollat fillore ka përfunduar regjistrimi i nxënësve në klasat e para dhe në edukimin para fillor .
 - Është bërë regjistrimi i nxënësve, në klasat e X-ta në të gjitha Shkollat e Mesme të Larta.
 - Sipas kalendarit te vitit shkollor te përcaktuar nga MASHT –i procesi mësimor për maturantë përfundoi më, 13.05.2016.
 - Për klasat e IX, X dhe XI mësimi përfundoi me datën, 03.06.2016, kurse për klasat nga I deri në VIII përfundoi më, 17.06.2016.
 - Po ashtu është bërë edhe ndarja e paraleleve në Potoqan të Epërm nga shkolla amë „Vëllezërit Frashëri” si shkollë në vete si dhe emërtimi i saj me emrin e dëshmorit ”Sakip Bellaqa”.
 - Si dhe riemërtimi i disa shkollave si „Mihail Grameno” në „Bekim Sylka”, Shkolla „Jusuf Gërvalla” në „Milaim Krasniqi”.
 - Është bërë po ashtu edhe emërtimi i shkollës së ulët të muzikës me emrin „ Faik Sylka”.
 - Është bërë edhe ndarja e paraleleve në Gur të Kuq nga shkolla amë „Mustaf Ibishi” si shkollë në vete si dhe emërtimi i saj me emrin ”31 Marsi”.
 - Është bërë riemërtimi i disa shkollave si „Patoqan i ulët ” në “ Dëshmorët e Lirisë”,
 - Është bërë edhe ndarja e paraleleve në Nagavc nga shkolla amë „ Bajram Curri” si shkollë në vete si dhe emërtimi i saj me emrin e dëshmorit ”Nesimi Elshani”.
- Gjatë muajit korrik dhe gusht 2016 janë organizuar aktivitete të rregullta për procesin edukativo-arsimor. Janë mbajtur takime zyrtare të DKA-së dhe drejtorëve të shkollave për koordinimin dhe kërkesat e punës, në mënyrë që të bëhen të gjitha përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2016/17.
- Në kuadër të DKA-së është formuar komisioni për verifikimin e nevojave dhe aktiviteteve që kanë shkollat.
- Në bashkëpunim me drejtorët e shkollave është bërë lyerja dhe pastrimi i shkollave,
- Në bazë të kërkesave dhe nevojave të shkollave janë shpallur konkurse dhe janë pranuar punëtorë.
- Me kohë është bërë shpërndarja e librave nëpër shkolla për nxënësit e klasës së I- rë deri në të IX-ta.
- Po ashtu është bërë edhe shpërndarja e materialit administrativë në të gjitha shkollat e komunës, si dhe furnizimi me lëndë djegëse është në proces.
- Projektet dhe meremetimet në shkolla
- Projekte të realizuara
- SHFMU “Hamzë Thaqi” Xërxe, rregullimi i kulmit të shkollës.
 - SHFMU “Bekim Sylka” Rahovec, rregullimi i oborrit të shkollës, fushës sportive, rregullimi i banjove, lyerja e shkollës, dhe pajisja e kabinetit të informatikës me kompjuter (donacion nga KFOR-i Italian).
 - SHFMU “Isa Boletini” Rahovec ,ndërtimi i shkollë së re.
 - SHFMU “Lidhja e Prizrenit” në Opterushë, ndërtimi i shkollës së re.
 - SHFMU “Milaim Krasniqi” në Pastasellë, rregullimi i oborrit dhe fushës sportive.
 - SHFMU “Isa Boletini” Rahovec ,pajisja e shkollës me “Smart TV”. Sipas projektit “Me mëso mua”, bashkëfinancim DKA - KEC-KFOS-SOROS.
 - SHFMU “Tre Dëshmorë” Vrajakë- Bratotin, rregullimi i oborrit, tavanit, dyshemeve dhe kulmit të shkollës.
 - SHFMU “ Nesimi Elshani” rregullimi i dyshemeve te klasave.
 - SHFMU “Bajram Curri” Krushë e Madhe, Pajisja me kabinet të informatikës.
 - SHFMU “Haki Stërmilli” Zaqishtë, rregullimi i Banjove.
 - SHML “Xhelal Hajda- Toni”, Pajisja e sallës së edukatës fizike me mjete konkretizimi.

- SHML “ Ukshin Hoti” Krushe e Madhe, rregullimi i fushës së sportit dhe njeje sanitare.
- SHML ” Selajdin Mullabazi – Mici” Rahovec , Kabineti i teknologjisë ushqimore, Projekt i ALLED në bashkëpunim me MASHT-in.
- SHML “Xhelal Hajda- Toni”, rregullimi i kanalizimit jashtë objektit te shkollës
- Caritas Zviceran, Pajisja e shtate shkollave me inventar të klasave për para fillor.
- Hapja e puseve ne shkolla, projekt nga BIK (shfmu”31Marsi” në Gur të kuq,) Vazhdon
- USAID –i pako të leximit dhe matematikës për 22 shkolla.
- Pajisje me mjete konkretizimi (llaptop, projector, skaner etj,) ne katër shkolla(Bekim Sylka, Liria, Heronjtë e Kosovës, Xh.H.-Toni) , nga MASHT.
- Projekte në vazhdim
- SHFMU “Mustaf Ibishi” në Kramovik, ndërtimi i shkollës se re.
- SHFMU “7 Shtatori” Rahovec, ndërtimi i shkollës së re , - MASHT
- SHFMU”4 Dëshmorët” në Ratkoc, ndërtimi i sallës sportive, - MASHT

Projekte të synuara për vitin 2017.

- SHFMU “Rilindja” Qifllak, rregullimi i kulmit të shkollës.
- SHFMU “Liria” Fortes, renovim i shkollës, infrastruktura e brendshme.
- SHFMU “Vëllezërit Frashëri” Drenoc, rregullimi i kulmit të shkollës dhe dyshemesë së klasave.
- SHFMU “Nesimi Elshani” Nagavc, rregullimi i oborrit të shkollës.
- SHFMU “ Bekim Sylka” Rahovec, rregullimi i kulmit të shkollës.
- SHFMU “ Ardhmëria” Rahovec, rregullimi i kulmit të shkollës.
- SHFMU “ Sylejman Vokshi” Palluzhë, rregullimi i oborrit të shkollës.
- SHFMU “Hamzë Thaqi” Xërxe, rregullimi i dritareve të shkollës.
- SHML “Xhelal Hajda – Toni, rrethimi i oborrit të shkollës.

Drejtoria komunale e Arsimit në Rahovec ka bërë të gjitha përgatitjet e duhura për fillimin e vitit të ri shkollor 2016-2017. Viti i ri shkollor ka qenë i paraparë të fillonte me 01.09.2016, por me vendim të MASHT-it fillimi i mësimit është shtyrë për datën 05.09.2016 .Me datë 05.09.2016 mësimi ka filluar me rregull në të gjitha SHFMU-të dhe SHML-të e komunës së Rahovecit

Komuna e Rahovecit ka këtë përbërje të shkollave, nxënësve dhe mësimitdhënësve:

1.	Shkolla të mesme te larta	3
2.	Shkolla Profesionale	1
3.	Shkolla Fillore te Mesme te Ulëta	26
4.	Paralelet e ndara fizike	7
5.	Çerdhe e fëmijëve	1
6.	Shkolla e Ultë e Muzikës	1
7.	Shkolla e Mesme Serbe	1
8.	Shkolla Fillore Serbe	2

Vitin e ri shkollor 2016-2017 për here të pare në klasën e parë e kanë filluar nxënës 908 të shpërndara në 50 paralele. Në klasat e X-ta janë regjistruar 913 nxënës. Shpërndarja e nxënësve të klasave të X-ta sipas shkollave është si në vijim

SHML”Xhelal Hajda-Toni”në klasë të X-të ka pranuar 342 nxënës.

SHML”Ukshin Hoti” në klasë të X-të ka pranuar 168 nxënës.

SHML”12 Maji” në Klasë të X-të ka pranuar 240 nxënës .

SHMLP”Selajdin Mullaabazi-Mici” në klasën e X-të ka pranuar 163 nxënës.

Numri i nxënësve në vitin shkollor 2016-2017

Niveli Numri I nxënësve

Çerdhja 57

Parafillor 877

Shkolla fillore të mesme të ulëta 7833

Shkolla e ultë e muzikës	112
Shkolla fillore serbe	82
Paralele me nevoja të veçanta	25
Shkolla te mesme të larta	2029
Shkolla Profesionale	441
Shkolla e mesme e lartë serbe	9

Total-----11465

Numri i përgjithshëm i punëtorëve të arsimit në fillim të vitit shkollor 2016/2017

1. Shkolla të mesme të ulëta 658 (mësimdhënës 549)
2. Shkolla të mesme të larta 155 (mësimdhënës 133)
3. Çerdhe 8 (mësimdhënës 4)

Gjithsej: 821 (mësimdhënës 686)

Niveli i sigurisë në shkolla është i kënaqshëm ,por me fokus të përhershëm të përmirësimit të kësaj situate me vendosjen e aparaturave të mbikëqyrjes dhe sigurisë për secilën shkollë për çka edhe është synim i DKA-së por për shkak të kufizimeve buxhetore ende nuk kemi arritur që të vendosim aparatura të tilla në të gjitha shkollat.

Sfidë për DKA-në gjatë kësaj periudhe ka qenë sistemimi i punëtorëve të arsimit sepse me zvogëlimin e numrit të nxënësve është zvogëluar edhe numri i orëve dhe si pasoj shumë punëtorë kanë mbetur pa norma të plota. Kjo mbetet shqetësim dhe sfidë edhe në të ardhmen.

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË DREJTORISË PËR BUXHET DHE FINANCA JANAR-DHJETOR 2016 Z. LULZIM SYLEJMANI

Ky raport përfshinë të dhënat për periudhën Janar- Dhjetor nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, konkretisht nga sektori për Buxhet &Financave dhe Sektori i Tatimit në Pronë.

❖ Sektori i Buxhetit dhe Financave

Bazuar në obligimet ligjore të cilat dalin nga Ligji mbi Financat Publike dhe Përgjegjësitë, është paraqitur Raporti i Shpenzimeve dhe të Hyrave për të vitit 2016 si informata për Kryetarin e Komunës dhe i njëjti do t'ju paraqitet edhe anëtarëve të Kuvendit në seancën e radhës të Asamblesë Komunale.

Nga ajo që na obligojnë ligjet në fuqi me përgjegjësi të plote mund të themi se prej fillimit të vitit 2014 deri në këto momente që po ju raportojmë me një përkushtim të madhe kemi arritur që Komuna e Rahovecit të bjer ne binar të stabiliteti financiar, ku mbi 95% të obligimeve të vjetra tashme janë shlyer ndaj operatorëve ekonomik, njëkohësisht duke mos hyr në obligime te reja pa mbulesë buxhetore.

Duke mos toleruar as me të voglin keqpërdorim të detyrës zyrtare, në Drejtorin e financave kemi arritur që pagesat të kryhen në afate ligjore dhe çdo e hyre të evidentohet dhe te dihet burimi i sajë.

Tek shpenzimet Operative kemi arritur të kursejmë pa e dëmtuar procesin e punës këto shpenzime: Shpenzime të telefon për 60%, Naftë për vetura për 30%, dreka zyrtare për 30%, mëditje për 50% etje.

Më lejoni që kronologjikisht t'ju përshkruajmë punën tone si drejtori duke respektuar edhe afate ligjore të rregulluara më ligjet që rregullojnë financat publike.

Sipas muajve për gjate vitit 2016 kemi realizuar këto detyra:

- Përgatitja e Cesh Planit për buxhetin e vitit 2016 - (Janar 2016),

- Përgatitja e raportit financiar për mbylljen e viti fiskal 2015 për Kuvendin komunal dhe Ministrin e Financave - (Janar 2016)
- Raport, (informatë) për shpenzimet dhe të hyrat për tremujorin e pare 2016 – (Prill 2016),
- Përgatitjet për buxhetin e vitit 2017, qarkorja e pare, KAB-it - qarkorja e dyte, (Maj-Korrik 2016),
- Rishikimi i buxheti për vitin 2016 në Kuvend - (Qershor 2016),
- Raport, (informatë) për shpenzimet dhe të hyrat për gjashtëmujorin e pare 2016 – (Korrik 2016),
- Dëgjimet buxhetore (12 dëgjime), punëtori për përgatitjen e buxhetit 2017 – (Gusht –Shator 2016),
- Dorëzimi në kuvendit i propozim buxhetit për vitin 2017 – (1 Shator 2016),
- Aprovimi i buxhetit për vitin 2017 në Kuvendin komunal – (27 Shtator 2016),
- Raporti financiar nëntë mujorin për MF - (Tetor 2016)
- Raporti (informatë) për shpenzimet dhe të hyrat për nëntë mujorin e vitit 2016 – (Tetor 2016),
- Përgatitje për mbylljen e vitit fiskal 2016, përcjellja e shpenzimeve ne baza ditore (Dhjetor 2016).

Komuna e Rahovecit për **vitin 2016** ka operon me një buxhet prej : **11,387,378.00** të përberë nga Grandi qeveritar dhe të hyrat vetanake:

- **Grandi i qeveritar** **10,229,364.00 euro,**
- **Të hyrat vetanake** **1,158,014.00 euro,**

Gjithsej: 11,387.978.00

Shpërndarja e buxhetit nëpër kategori ekonomike ne vitin 2016 është siç vijon:

- **Paga e mëditje** **6,895,620.00 euro,**
- **Investime kapitale** **3,408,652.00 euro,**
- **Mallra dhe shërbime** **683,913.00 euro,**
- **Shpenzime komunal** **250,500.00 euro,**
- **Subvencione** **148,693.00 euro.**

Të hyrat e bartura nga viti 2015 në vitin 2016 janë 247,444.00 euro.

Të hyrat e donatoreve nëpërmjet SIMFK-s janë 106,014.47 euro.

Duke u mbështetur në LMFPP, Ministria e Financave ka dërguar Instruksionin për Rishikim të Buxhetit për vitin 2016. Duke u bazuar në këtë instruksion, është bërë përgatitja e Propozim Vendimit për Rishikim Buxhetor për vitin 2016 me dokumentacionin përcjellës dhe është dorëzuar ne Kuvend Komunal. Rishikimi Buxhetor për vitin 2016 është miratuar nga Asambleja Komunale me 24.05.2016 dhe vendimi mbi miratimin dhe dokumentacioni përcjellës është dërguar MF-Prishtinë, i cili rishikim ka kaluar në Qeveri dhe Kuvendin e Republikës se Kosovës.

Bazuar në Ligjin mbi Financat Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullat Financiare, ZKF-ja ka bërë raportimin e rregullt te obligimeve financiare për çdo muaj dhe obligimet e mëparshme në Ministrinë e Financave respektivisht në Thesarin Qendror.

❖ **Shpenzimi i buxheti**

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë zotuar 2,718 lëndë dhe janë kryer 2,574 pagesa. Janar-Dhjetor 2016

Nr.	Përshkrimi	Lëndët	Buxheti alokuar	Shpenzimet	Shpenzimi në %
1	Paga dhe mëditje		6,970,719.16	6,966,078.46	99.93

2	Mallra dhe Shërbime	1190	694,851.26	657,624.74	94.64
3	Shërbime Komunale	712	250,500.00	250,497.13	100.00
4	Subvencione	266	174,340.30	173,991.88	99.80
5	Investime Kapitale	173	3,740,743.34	3,518,824.19	94.07
	Totali	2574	11,831,154.06	11,567,016.40	97.77

❖ **Të hyrat vetanake**

➤ **Tatimi në prone**

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2016 sektori i tatimit në pronë ka realizuar të hyra prej 370,509.26 apo 112 % të planifikimit vjetor (planifikimi vjetor 330,000.00) euro. Gjate vitit 2016 në sektorin e tatimit në prone janë lëshuar 21,884 certifikata dhe janë paguar 8,951 fatura.

Nga këto takime me qytetarët kërkojmë që ti shlyejnë detyrimet ndaj komunës, konkretisht tatimit në prone sepse 95% e këtyre të hyrave ju kthehen qytetarëve me projekte në infrastrukturë në vendbanimet ku jetojnë, njëherit i inkurajojmë që të shfrytëzohet ligji për faljen e borxheve pasi i njëjti është zgjatur edhe për 6 muaj në vitin 2017.

➤ **Të hyrat në përgjithësi:**

Të hyrat e përgjithshme vetanake të realizuara për këtë periudhë janë **1,009,923.57 euro** apo 87.2% të planifikimit vjetor (planifikimi vjetor 1,158,014.00).

❖ **Përgatitja e buxheti për vitin 2017**



Me 24.05.2016 kemi pranuar Qarkoren Buxhetore 2017/1 nga Ministria e Financave e cila paraqet bazën për hartimin e Buxhetit për vitin 2017 dhe vlerësimet për vitet 2018 dhe 2019. Me këtë qarkore buxhetore janë ndare kufijtë fillestar buxhetor për vitin 2017, ku Komunës së Rahovecit sipas kësaj Qarkoreje ju është ndar një buxhet prej **11,908,739.00€**

Kemi përgatitur dhe kemi dërguar në Kuvend **Kornizën Afatmesme Buxhetore - KAB** për vitet 2017-2019 e cila është aprovuar në Kuvend.

Kemi përgatit dhe dërguar në kuvend propozim buxhetin për vitin 2017 i cili është miratuar me shumicë votash të pozitës dhe opozitës.

Buxheti i aprovuar për vitin 2017 është **11,908,739.00 euro** - (**10,661,007.00 Grandi Qeveritar** – **124,732.00 të Hyrat Vetanake**) i ndare nëpër kategori ekonomike siç vijon :

- **Paga dhe medijtje 7,028,178.00€,**
- **Investime kapitale 3,732,629.00€,**
- **Mallra dhe shërbime.....706,110.00€,**
- **Komunali 250,500.00€,**
- **Subvencione dhe transfere ... 191,322.00€.**

Gjithsej : 11,908,739.00 €

Sfidat për vitin 2016:

- ✓ Realizimi (inkasimi) i të hyrave vetanake gjate këtij viti,
- ✓ Përgatitja e buxhetit për vitin 2017 (Rritja e kategorisë së subvencioneve dhe mbulushmeria me paga),
- ✓ Stafi jo i mjaftueshëm në sektorin e tatimit në prone.

RAPORTI VJETOR I DREJTORISË PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL JANAR-DHJETOR 2016 Z.FEIM FETOSHI

Në Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Komuna Rahovec në periudhën Janar – Dhjetor 2016 janë zhvilluar këto aktivitete:

- Projekti “Ndërtimin e Serave me bashkëfinancim (75:25)” është përfunduar në tërësi dhe është kryer edhe pranimi teknik. Në kuadër të këtij projekti 93 Fermer kanë përfituar Sera me sipërfaqe prej 150 m². Ky Projekt ka pasur vlerën e tërësishme 102095,4 €. Nga kjo, 76571,55 € ka paguar Komuna gjersa me 25523,85 € kanë participuar fermerët përfitues.
- Projekti "Zgjerimi i sistemit të ujitjes në Ratkoc, Vrajak dhe Bratatin" është përfunduar në tërësi dhe është kryer edhe pranimi teknik. Projekti ka vlerën 279644,96 €. Ky projekt është realizuar në bashkëfinancim të Komunës me MBPZHR. Me 184813,8 € projektin e ka financuar MBPZHR, gjersa pjesa tjetër prej 94831,16 € është financuar nga Komuna e Rahovecit. Deri tani Komuna ka paguar 90000 €, gjersa pjesa tjetër prej 4831,16 € do të realizohet gjate vitit 2017! Me këtë projekt do të mundësohet ujitja për 73 Ha tokë të punueshme.
- Në kuadër të projektit “Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore”, janë ndërtuar apo rregulluar 4 rrugë fushore:
 1. Rruga fushore në fshatin Zoqisht - Vreshtat - Izbisht në gjatësi L= 2430m (në projekt janë L=2028), sipas situacionit me vlerë prej 35170,02€
 2. Rruga fushore Paskedol - Jolgjin - Patok me gjatësi L=3381m, sipas situacionit me vlerë prej 63727,64€
 3. Rruga fushore Dacakoll - Hamoviç - Paskidol me gjatësi L=3862, sipas situacionit me vlerë prej 27961,73€
 4. Rruga fushore afër Lumit të Bellajës në Fortesë me gjatësi L = 1125m, sipas situacionit me vlerë prej 17078,71€,
 5. Rregullimi i rrugës fushore Vragovishte - Ragovishte me gjatësi L= 388,8m, sipas situacionit me vlerë prej 7356,4€.

Për ndërtimin e këtyre rrugëve fushore ekziston projekti me 13 rrugë në kuadër të së cilit janë ndërtuar edhe 5 rrugët e lartshënuara. Këtë vit janë kryer punë në vlerë rreth 151294,5, gjersa janë paguar 141274€.

- Në kuadër të projektit "Kanali i kullimit të tokave bujqësore në komunën e Rahovecit" këtë vit nuk janë zhvilluar punime, por është bërë pagesa për punët e kryera në projektin Ndërtimin e kanalit për kullimin e tokave në Malësi e Vogël në vlerë 70402,5€ për punët e ekzekutuara në vitin 2015.
- Në kuadër të projektit "Pastrimi i prrockave në komunën e Rahovecit" janë pastruar prrocka në Krushë të Madhe në gjatësi prej 800 m, Kanali te liqeni Bllato në gjatësi prej 375 m dhe prrocka Rimnik në gjatësi prej 1580 m. Projekti është në përfundim e sipër, pasi që kanë mbetur edhe disa punë të vogla për tu riparuar, kjo për shkak të neglizhencës së organit mbikëqyrës! Vlera e këtij projekti është 7831,5 €. Mjetet e këtij projekti janë nga të Hyrat vetanake dhe ne si drejtori do të propozojmë që këto mjete të barten për vitin fiskal 2017 në mënyrë që operatorit ekonomik ti bëhet pagesa pasi që të përfundojnë punët e mbetura dhe të sanohen mangësitë e konstatuara.
- Në proces është projekti "Ndërtimi i infrastrukturës për festivalin dhe tregun e rrushit". Projekti ka vlere prej 215,995 €. Projekti është një bashkëfinancim i Komunës sonë me MBPZHR. Për këtë vit kanë qenë në dispozicion dhe janë paguar 80000 €, ku nga MBPZHR janë ndarë 70000€ gjersa nga Komuna e Rahovecit 10000 €.

- Gjatë periudhës për aplikim për Grande në MBPZHR, drejtorja jonë ka dhënë këshillime dhe asistencë profesionale për të gjithë Fermerët e interesuar të cilët kanë aplikuar për grande në sektorë të ndryshëm. Këtë vit nga komuna e Rahovecit, 84 qytetarë apo subjekte afariste kanë përfitua grande nga MBPZHR, vlera totale e të cilave është 1,647.880 €.
- Në kuadër të aplikimit për pagesa direkte (subvencione) për Fermerë, Drejtorja e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka qenë e mobilizuar mirë, dhe përkundër fluksit të madh të aplikuesve (2990 aplikues) procesi është përfunduar me sukses! Nga ky proces Fermerët e Komunës së Rahovecit këtë vit janë subvencionuar me një vlerë prej 4,267.547 €.
- Në kuadër të DBPZHR në bashkëpunim me MBPZHR funksionon shërbimi këshillues, ku brenda vitit 2016 janë organizuar 15 takime këshilluese në të cilat kanë marr pjesë 216 Fermerë.
- Gjate vitit 2016 në Drejtorinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural Janë trajtuar 230 lëndë dhe kërkesa të ndryshme.
- Me 11.11.2016 DBPZHR në bashkëpunim me Qendrën Grumbulluese të Frutave dhe Perimeve “Agrocelina” ka organizuar konferencën me temën “Sfidat në prodhimtarinë e specit në regjionin e Anadrinisë”. Në këtë konferencë kanë marr pjesë mbi 130 Fermerë dhe ekspertë nga të gjitha institucionet relevante të Republikës së Kosovës.
- Në kuadër të bashkëpunimit që ka DBPZHR me IADK-në me seli në Vushtrri me financim të UNDP-së janë ndërtuar 2 (dy) sera me sipërfaqe 200 m2 sera këto të ndërtuara bashkë më tërë infrastrukturën përcjellëse. Ky projekt ka pasur vlerën 8000€.
- DBPZHR - Rahovec ka menaxhuar fushatën e Korrje - Shirjeve 2016, fushatë kjo e cila ka kaluar me sukses. Sipërfaqet e mbjella me grurë në komunën e Rahovecit për vitin 2016 ishin rreth 1834 Ha, ndërsa me elb 4,11 Ha. Rendimenti mesatar për komunën tonë këtë vit ishte 4600 kg/Ha për grurë dhe 2800 kg/Ha për elb. Falë angazhimeve nga të gjithë akterët e përfshirë në këtë fushatë dhe kohës së mire që ka mbretëruar, në komunën e Rahovecit, korrje – shirja për vitin 2016 ka përfunduar me datën 26.07.2016.

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË DREJTORISË PËR URBANIZËM, MBROJTJE TË MJEDISIT JANAR-DHJETOR 2016 Z. FEHMI HOXHA

Në kuadër të kësaj Drejtorie funksionojnë dy sektor:

1. Sektori për Urbanizëm dhe Planifikim
2. Sektori për Mbrojtje të Mjedisit si dhe
3. Zyra për legalizimin e ndërtimeve pa leje

SEKTORI PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM

Ky sektor ka realizuar këto aktivitete :

Sistematizimi i lëndëve të ndryshme

Koordinimi i punës në sektor

Koordinimi i rregullt me stafin

Barazimi me zyrtarin e të hyrave

Menaxhimi dhe kontrollimi i rregullt i projekteve kapitale

Zgjidhje dhe përgjigje ne kërkesat e qytetareve
Përgatitja e projekteve konkurruese ideore
Vizitat e punimeve në teren-inspektimi i punimeve
Përgatitja dhe lëshimi i kushteve ndërtimore
Përgatitja dhe lëshimi i lejeve ndërtimore
Pranime teknike të disa projekteve
Mbajtja e disa seminareve të organizuara nga organizata te ndryshme
Takimet me grupet punuese. UN-Hbitati, CHWB-Trashëgimia Kulturore

Investimet Kapitale:

Projekti “Mbikëqyrja e projekteve te ndryshme”
Vazhdimi i punimeve ne Projektin “Ndërtimi i ndërtesës për persona ne nevojë”
Vazhdimi i punimeve ne projektin “Rregullimi i shtratit te lumit Zoqisht”
Vazhdimi i punimeve ne projektin “Rregullimi i shtratit te lumit Rimmnik “ne Fortese
Vazhdimi i punimeve ne projektin “Rregullimi i shtratit te lumit Duhlllo” në Rahovec
